

1 E hënë, 24 shkurt 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

6 Sekretar i seancës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju
10 faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Përpara se të vijë dëshmitari, do nxjerrim dy urdhra me
15 gojë.

16 Së pari, Trupi Gjykses do të nxjerrë urdhër, rregull me
17 vendimet e rregullës 153 dhe të parashtrimit të protokolluar
18 FR02779.

19 Më 13 dhjetor 2024, Prokuroria kërkoi që t'i vendosej një
20 numër prove materialit me numër 061011-TR-AT Pjesa 2 RED2, që
21 është Pjesa 2 e transkriptit të shqipes të Dëshmitarit të
22 Prokurorisë me numër W04394 që u pranua në fakt si dokument
23 sipas rregullës 153 në vendimin F02779 të Trupit Gjykses.

24 Prokuroria thotë që për një gabim administrativ nuk i
25 është vendosur numri këtij dokumenti.

1 Trupi Gjykues vëren se intervista e Dëshmitarit 04394 në
2 fakt, është pranuar si provë gjyqësore sipas rregullës 153.

3 Dhe më konkretisht kjo është përmendur në dokumentin
4 F02779, paragrafi 83(c).

5 Prokuroria propozon që t'i vendoset numër materialit
6 061011-TR-AT. Dhe Prokuroria më konkretisht propozon që numri
7 që do t'i jepet këtij dokumenti të jetë me numër P01930.1-AT.
8 Dhe materialit 06111-TR-AT t'i jepet numri P01930.2-AT.

9 Ka kundërshtime nga Mbrojtja për këtë? Asnjë mesa shoh.

10 Trupi Gjykues e miraton kërkesën e ZPS-së dhe udhëzon
11 Zyrën Administrative që t'i japë numrin përkatës materialit
12 061011-TR-AT Pjesa 1 RED2 dhe numri të jetë numri që u
13 propozua nga Prokuroria, përkatësisht 01930.1-AT dhe
14 materialit 0161011-TR-AT Pjesa 2 RED2 t'i japë numrin e provës
15 P01930.2-AT.

16 Me këtë mbyll urdhrin e parë me gojë.

17 Ka dhe një çështje tjetër organizimi që duam ta trajtojmë
18 lidhur me dokumentin e protokolluar F02779.

19 Po fillimisht ju lutem të kalojmë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do fillojmë

19 me dëshminë tani, dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë

20 W04745.

21 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin, a

23 mund të flasim lidhur me atë aspektin që trajtuam me email

24 javën e kaluar lidhur me Dëshmitarin 02677, kemi ndonjë -- a

25 do na thoni a do e pranoni propozimin që kemi bërë ne, apo jo,

1 keni ndonjë ide në këto momente?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju them
3 lidhur me këtë. Faleminderit.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
6 Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi dhe juve. Dhe përshëndetje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A na dëgjon
9 mirë?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë mirë.
12 Dëshmitar, do fillojmë tani me dëshminë tuaj. Sekretarja e
13 Gjykatës do t'ju japë betimin solemn që duhet ta bëni në
14 përputhje me rregulloren. Lexo me zë të lartë tekstin që ke
15 përpara.

16 DËSHMITARI: Më falni, unë dëshiroj një përshëndetje një
17 herë të përgjithshme për të gjithë të pranishmit këtu.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lexoni ju
19 lutem tekstin. Lexoni tekstin, ju lutem. Lexoni me zë të lartë
20 tekstin.

21 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
22 dhe përgjegjësisë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
23 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
24 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

25 Beto hem në emër të drejtësisë së Zotit tim dhe në drejtësinë e

1 ligjeve tuaja, në qoftë se ekzistojnë.

2 DËSHMITARI: ISMET TARA

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
4 uleni, Dëshmitar. Faleminderit.

5 Dëshmitar, keni një kërkesë, doni të bëni një deklaratë
6 keni thënë. Ne nuk kemi asnjë problem, pra duhet ta bëni në
7 fund të dëshmisë suaj. Mirë? Që të mos ketë ndërhyrje në
8 dëshminë tuaj. Kështu që do fillojmë me dëshminë, fillimisht
9 Prokuroria, pastaj Mbrojtja, kur të mbarojnë të gjitha palët
10 do t'ju japim mundësinë që të bëni deklaratën që dëshironi të
11 bëni, por në fund të dëshmisë suaj. E kuptoni këtë?

12 DËSHMITARI: E kuptoj. Por në pyetjen e parë të Prokurores
13 time, unë dëshmitar, dëshiroj që ta shprehi shqetësimin tim
14 lidhur me këtë problem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast. Një
16 çast. Një çast, ju lutem. Këtu keni ardhur për të dhënë dëshmi
17 dhe dëshmia juaj do të jepet vetëm përmes përgjigjeve. Ju
18 thashë, pasi të keni përfunduar dëshminë, do t'ua japim
19 mundësinë ta bëni deklaratën. Por duhet të bëhen një herë
20 pyetjet dhe kur t'i bëjë pyetjet Prokuroria dhe Mbrojtja ju
21 duhet t'i përgjigjeni. Nuk duhet të bëni deklarata tani, në
22 këtë momente. Janë avokatët këtu për këtë punë.

23 DËSHMITARI: Unë dua t'i shprehi shqetësimet e mia në bazë
24 të asaj që kam gjet parregullsi në këtë Gjykatë. Pastaj të
25 flas.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem. ju
2 lutem. Jua fikëm mikrofonin sepse nuk po e kuptoni. Ua fika
3 mikrofonin sepse nuk po e kuptoni këtë që po ju them. Tani e
4 ndeza prapë.

5 Po ua shpjegoj edhe një herë. Do t'ju bëjë fillimisht
6 pyetjet Prokuroria, pastaj do t'ju bëjnë pyetje Ekipet e
7 Mbrojtjes dhe kur të mbarojë Prokuroria dhe Avokatët Mbrojtës,
8 mund t'i ngrini të gjitha shqetësimet që keni. Këto janë
9 rregulla të Gjykatës, Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: Mirë. Faleminders.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani,
12 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet se
13 do të zgjasë përafërsisht tre ditë. Fillimisht pyetjet i bën
14 Prokuroria. Pas Prokurorisë, Ekipet e Mbrojtjes mund t'ju
15 bëjnë pyetje, por pyetje mund të kenë edhe Gjykatësit.

16 Prokuroria ka parashikuar gjashtë orë për pyetjet e veta.
17 Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar rreth tetë orë e gjysëm.
18 Inkurajoj të gjitha palët të jenë sa më të kujdesshme në
19 shfrytëzimin e kohës dhe Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje
20 plotësuese nëse përmbushen kushtet.

21 Dëshmitar, ju lutem, përgjigju qartë, me fjali të
22 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që
23 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni. Gjithashtu na
24 thoni ku e bazoni ju faktet, rrethanat për të cilat do të
25 jepni përgjigje.

1 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të flisni për
2 korrigjimet që i keni bëra deklaratave, ju lutem konfirmoni
3 për procesverbal që deklaratata me shkrim, bashkë me korrigjimet
4 përkatëse, pasqyron saktësisht deklaratën tuaj.

5 Flisni pranë mikrofonit, prisni pesë sekonda përpara se
6 të përgjigjeni dhe flisni ngadalë që t'ju ndjekin përkthyesit.

7 Gjatë kohës që jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi, nuk
8 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
9 jashtë Gjykatës. Në qoftë se një pëson jashtë Gjykatës ju bën
10 pyetje për dëshminë tuaj, na informoni menjëherë. Ju lutem
11 nëse ua them unë të mos flisni më, ndërpritni fjalën dhe mos
12 fol më nëse më sheh që unë po ngre dorën. Sepse kjo do të
13 thotë që unë dua të jap udhëzime.

14 Në çdo moment që keni nevojë për pushime, na thuaj, ngri
15 dorën dhe do të bëjmë organizimin përkatës.

16 Fillojmë me pyetjet e Prokurorisë, që janë ulur në të
17 majtën tuaj. Dëgjoje, dëgjoje me vëmendje, ua kam shpjeguar si
18 është procedura. Dëgjoni pyetjen.

19 DËSHMITARI: Zërin edh pak ngriteni.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjon më
21 mirë? Më lart?

22 DËSHMITARI: Më lart.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është më
24 mirë?

25 A dëgjon më mirë tani?

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 8

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Mirë.

3 Mirë atëherë.

4 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

5 Pyetje nga znj. Iodice:

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

7 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

8 PË. Mirëmëngjesi.

9 PY. Unë quhem Vega Iodice dhe unë do t'ju bëj pyetjet në emër
10 të Prokurorisë.

11 Pikësëpari, na thoni emrin dhe mbiemrin për procesverbal?

12 PË. Ismet Tara.

13 PY. Datëlindja juaj cila është?

14 PË. 8 qershor 1963.

15 PY. Çfarë shtetësie keni?

16 PË. Jam kosovar.

17 PY. Çfarë profesioni keni?

18 PË. Profesioni hotelier.

19 PY. Faleminderit. A keni pasur ndonjëherë ndonjë nofkë?

20 Ndonjë pseudonim, ndonjë nofkë keni pas?

21 PË. Bënu më e qartë gjatë cilës periudhë?

22 PË. Gjatë luftës a ke pas ndonjë nofkë?

23 PË. Po.

24 PY. Cila ka qenë kjo nofkë?

25 PË. Hoxha.

1 PY. Faleminderit. A keni pasur ju, jeni stërvitur, keni pasur
2 formim ushtarak?

3 PË. Qartësoje prapë pyetjen.

4 PË. A jeni -- a keni marrë ndonjë herë ndonjë trajnim
5 ushtarak, për shembull, a keni kryer shërbimin ushtarak, a
6 keni kryer ndonjë trajnim ushtarak?

7 PË. Kam qenë ushtar i ish-Jugosllavisë në Sarajevë në vitin
8 1983-1984.

9 PY. Faleminderit. Tani do t'ju pyes për kontaktet e para që
10 keni pasur me UÇK-në. U theksoj dhe një herë, ju lutem,
11 dëgjoni me vëmendje pyetjen dhe jepni përgjigjen përkatëse. Po
12 flisni me mikrofon, kështu që flisni me tonin tuaj normal. Ne
13 ju dëgjojmë mirë. Ne ju dëgjojmë.

14 Në fillim, kur je bërë zyrtarisht ushtar i UÇK-së?

15 PË. Zyrtarisht ushtar i UÇK-së me daljen e shtabit Arti diku
16 ka mesi i muajit maj 1998.

17 PY. Po përpara kësaj periudhe, a e përkrahje ti UÇK-në?

18 PË. Po, me të gjitha mundësitë e mia.

19 PY. Faleminderit. A do na tregoni pak ju lutem në praktikë,
20 në realitet si e ke përkrah UÇK-në? Çfarë bëje ti?

21 PË. Mbas vrasjes së familjes së Adem Jasharit, kanë dëgjuar i
22 tërë populli im për masakrat e serbëve, kriminelëve serbë që
23 kanë bë vrasje në një familje gati të tërë. Kështu edhe unë
24 kam dëgjuar dhe kam kërkuar njohuri sa më shpejt të shkoj t'i
25 ndihmoj ushtrisë sime, UÇK-së.

1 PY. Çfarë ndihme, çfarë mbështetje u ke dhënë? Çfarë ke bërë?

2 PË. Me ndihma materiale deri në shtabin e Rahovecit unë kam
3 punuar vetëm me ndihmën materiale UÇK-së.

4 PY. Cilën njësi të UÇK-së ke mbështet fillimisht?

5 PË. Në fillim e kam mbështet njësitin në Likovc, Rezallë dhe
6 Plluzhinë.

7 PY. Në cilin territor është kjo?

8 PË. Kjo është në territorin e Drenicës.

9 PY. Si mësove, si e mësove ti për këto njësite të UÇK-së? Nga
10 e mësove si të shkoje atje?

11 PË. Për këtë njësitë që UÇK-së ka lyp informata prej Gani
12 Krasniqit të Malishevës.

13 PY. Kush ishte ky Gani Krasniqi? A ishte i lidh me UÇK-në?

14 PË. Gani Krasniqi kur unë e kam kërkuar e kam njoftur më
15 herët si ish i burgosuri politik i një kohe të gjatë dhe kam
16 menduar se ai ka informacion për ekzistimin e grupeve të UÇK-
17 së në Kosovën time.

18 PY. A mësove ndonjëherë a ka qenë ai anëtar i UÇK-së?

19 PË. E kam, pastaj e kam mësuar mbas takimit të disa herë me
20 të e kam mësuar që ai ka qenë veç anëtar i UÇK-së edhe në atë
21 kohë sa e kam pyetur unë.

22 PY. Në cilin njësit të UÇK-së ishte ky?

23 PË. Ky ka qenë në njësitin e Malishevës, emrin e të cilin unë
24 nuk e kam ditur kur e kam takuar herën e parë.

25 PY. Po emrin a ja mësove ndonjëherë?

1 PË. Po.

2 PY. Na e thuaj?

3 PË. Njësiti Lumi i Malishevës.

4 PY. Faleminderit. Kur ke shku për herë të parë në zonën e
5 Drenicës për t'i dhënë furnizimet UÇK-së?

6 PË. Për herë të parë ka qenë 11, 12 ose 13 marsi. Nuk jam
7 tamam i saktë në cilën datë. Prej këtyne tri datave njëra datë
8 është, 11, 12, 13 mars 1998.

9 PY. Në rregull. Me kë shkove?

10 PË. Më së pari kam shkuar me Gani Krasniqin.

11 PY. The që ke shkuar Rezallë, Plluzhinë, Likoc. Për sa kohë e
12 ke furnizuar Rezallën dhe Plluzhinën?

13 PË. Deri në daljen e shtabit të Drenovcit.

14 PY. Po Likocin sa kohë e ke furnizuar?

15 PË. Rezalla, Likovci dhe Plluzhina janë tre fshatra afër
16 njëra-tjetrës dhe ku ata më kanë kërkuar që unë të shprazi
17 ndihmat e mia, q'aty i kam shprazur.

18 PY. Ku ke shku në Likoc për t'i shpu këto sende?

19 PË. Tregova në tre datat, në tre datat që unë kam nisur, po
20 më së pari kam furnizuar në depon e Rezallës, pastaj në një
21 depo në Plluzhinë, pastaj në fund në Likoc.

22 PY. Në Likoc ku ka qenë kjo depo?

23 PË. Kjo depo në Likoc ka qenë menjëherë me mbërritjen prej
24 rrugës që të çon nga Likovci në anën e majtë menjëherë gjatë
25 rrugës time që kam shkuar, menjëherë në anën e majtë, ku ka

1 qenë një depo dhe një furrë e bukës për ushtarët, për

2 përgatitjen e bukës për ushtarët.

3 PY. A je taku me anëtarë të tjerë të UÇK-së në Likoc?

4 PË. Jo. Me depoistët dhe me ushtarët që kanë bërë shprazjen
5 e materialit tim, por ata kanë qenë në civilka kryesisht, në
6 rroba civile.

7 PY. A ka pas anëtarë të tjerë në Likoc që ke takuar gjatë

8 këtyre udhëtimeve, jo domosdoshmërisht tek kjo depoja po gjatë
9 kohës që ke shku në Likoc a ke takuar anëtarë të tjerë?

10 PË. Po. Ushtarët kur kam filluar unë të shkoj në fillim

11 kryesisht kanë qenë me maska, të mbuluar me maska. Dhe gjatë
12 rrugëtimit tim përpara se të mbërrihet në Likoc ka pas pika
13 sigurimi për ata ushtarë që kanë qëndruar nalt në Likoc,

14 Plluzhinë e në Rezallë. Ushtarët --

15 PY. Të kujtohet ndonjë ushtar i UÇK-së që nuk kishte maska?

16 PË. Po. Po, më kujtohet.

17 PY. Kë ke parë?

18 PË. Kam parë heroin tim, të kombit tim, të UÇK-së Fehmi

19 Lladrovcin dhe Xhevë Lladrovcin së bashku në pikat më të rënda
20 të sigurimit të ushtarëve të tij.

21 PY. Faleminderit. A e dini çfarë roli kishte Fehmi Lladrovci
22 në UÇK?

23 PË. Në fillim nuk e kam ditur sepse ai ka qenë në pikë si
24 ushtar i thjeshtë. Po pastaj e kam kuptuar që ai ka një rol në
25 UÇK.

1 PY. A ke njohur ndonjë person tjetër në Likoc apo Drenicë?

2 PË. Unë ja u thashë, unë jam takuar edhe me ushtarë gjatë
3 udhëtimit tim, por nuk i kam njohur dhe nuk kam qenë i
4 interesuar t'i njoh sepse vij nga një qytet në të cilin
5 jetojnë 5.000 serbë dhe nuk kam guxuar edhe për veti t'i kem
6 informata, po ndoshta dhe ata atëherë ata ushtarë që kanë qenë
7 aty nuk do të m'i kishin dhënë informata ose disa -- ose do të
8 isha, do të kisha qenë i dyshuar pse po pyes për ata ushtarë.

9 PY. Faleminderit. A e ke mësu ndonjëherë identitetin e
10 anëtarëve të tjerë të UÇK-së që ke takuar në Drenicë edhe pas
11 luftës, pra, e mësuar mos edhe pas luftës identitetin?

12 PË. Po, kam mësuar identitetin e tyre, të legjendave të mi të
13 kombit, gjatë përfaqësimit tonë në Rambuje, në Konferencën e
14 Rambujesë.

15 PY. Fokusohemi tek pyetja. A mësove ndonjëherë kush ishin
16 anëtarët e UÇK-së që kishe takuar në Drenicë, a e mësove
17 ndonjëherë kur ishin këta?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe, nëse po, kush ishin këta?

20 PË. Hashim Thaçin e kam kuptuar gjatë procesit të Rambujesë,
21 po pastaj edhe pas luftës edhe me ardhjen time si komandant
22 dhe për herë të parë fizikisht jemi takuar në përvjetorin, 17
23 korrikun e 1999, përvjetorin e parë të betejës së Rahovecit.

24 PY. Si e mësove ti që kishe takuar Hashim Thaçin në Drenicë?

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kundërshtoj, nuk tha këtë

1 dëshmitari.

2 DËSHMITARI: Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast. Një
4 çast, Dëshmitar. Një çast.

5 DËSHMITARI: Jo.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sqaroheni ju
7 lutem, Prokurore.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

9 PY. Z. Tara, sapo the që e ke mësua për Hashim Thaçin gjatë
10 bisedimeve të Rambujesë po dhe kur e ke takuar personalisht.
11 Çfarë ke mësua, çfarë ke kuptuar, pra, çfarë ke kuptuar për
12 Hashim Thaçin kur e ke takuar pas luftës?

13 PË. Kur e kam takuar pas luftës më 17 korrik, ai ka qenë
14 vetëm zyrtarisht edhe kryeministër i Qeverisë së Përkohshme.

15 PY. Z. Tara, po ju pyes a e mësove në ndonjë moment apo a e
16 kuptove në ndonjë moment që identiteti i personave që ke
17 takuar në Drenicë në 1998-n, pra, a keni mësua ndonjëherë apo
18 keni kuptuar ndonjëherë identitetin e anëtarëve të UÇK-së që
19 ke takuar në Drenicë, pra, kush ishin këta persona? Kur e
20 mësove ti që kush ishin personat që ke takuar në Drenicë, kush
21 ishin këta personat që kishe takuar në Drenicë?

22 PË. Unë që i kam takuar në Drenicë nuk i kam njoftur, znj.
23 Prokurore. Por i kam njohur pastaj mbas takimit tim fizik me
24 ta. Unë mirë ua shpjegova se për herë të parë jam njoftuar
25 gjatë Konferencës së Rambujesë që është mbajtur se Hashim Thaçi

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 15

1 është përfaqësues i lartë zyrtar i UÇK-së dhe pastaj kam --
2 jam njohur me ata dhe kam kuptuar që ata kanë qenë. Ajo që unë
3 i kam njoftur prej Drenicës se kush janë. Jam i qartë,
4 Gjykatës?

5 PY. Dëshmitar, nuk po i përgjigjeni pyetjes sime.

6 PË. Atëherë, atëherë --

7 PY. Edhe një sekondë, ju lutem prisni --

8 PË. -- plotësoje ose ndryshoje pyetjen në mënyrë tjetër.

9 PY. Prisni që të përfundojë unë dhe pastaj jepni përgjigjen,
10 z. Tara.

11 PË. Okej.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni,
13 Dëshmitar.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mendoj që dëshmitari po i
15 përgjigjet pyetjes.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe mua mu
17 duk sikur po i përgjigjet pyetjes dëshmitari, mënyra sesi ia
18 bëtë pyetjen, Prokurore. Në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër
19 për t'i thënë mund ta pyesni.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Z. Tara, --

22 PË. Urdhnoni edhe pak afroni mikrofonin sepse nuk dëgjojeni
23 bash mirë.

24 PY. Z. Tara, dëgjoni më mirë tani?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 16

1 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
2 këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta do
4 duhet të ndryshohet volumi.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

6 PY. Z. Tara, a ju ka informuar ndonjëherë ndonjë person
7 lidhur me emrin, mbiemrin e personave të UÇK-së, pjesëtarëve
8 të UÇK-së që keni takuar në Drenicë në vitin 1998?

9 PË. Jo.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar
11 Gjykatës, dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit një deklaratë të
12 mëparshme, dua t'ia tregoj në pajtim me rregullën 123(b) dhe
13 (c).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

16 Do i kërkoja Sekretares tani të paraqesë në ekran
17 dokumentin 125903 deri në 125933 në faqen në PDF 27. Të
18 përqendrohemi tek paragrafi 140.

19 DËSHMITARI: Unë dua përkthim në shqip.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Z. Tara, ju lutem prisni që të bëj pyetjen. Do ju lexoj
22 një pjesë të deklaratës tuaj. Në paragrafin 140 thuhet:

23 "Dëshmitari thotë që një kohë pas luftës Hashim Thaçi i
24 ka treguar Dëshmitarit 04754 që ai e kishte takuar atë në
25 Drenicë në mars të vitit 1998. Megjithatë, dëshmitari në kohën

1 e takimit nuk e dinte që personi ishte Hashim Thaçi.”

2 A është pasqyrim i saktë ky i dëshmisë tuaj, Dëshmitar?

3 PË. Ky është pasqyrimi saktë i imi. Mirëpo pyetja juaj nuk
4 është e drejtë. Atë mund të pyesni Hashim Thaçin në qoftë se
5 më ka takuar ose jo. Gjatë njoftimit tim pas luftës më ka
6 thënë që “Unë ju kam parë juve, unë ju kam parë juve”, po nuk
7 më ka treguar identitetin e tij. Kjo nuk është -- Okej.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
9 lutem thjesht përgjigjuni pyetjes.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

11 PY. Faleminderit, z. Tara. Ju përgjigjët pyetjes time.

12 Tani dëshiroj t’ju bëj disa pyetje të tjera që kanë të
13 bëjnë me personelin e UÇK-së, me shtabin e UÇK-së në
14 Malishevë. Së pari, a mund të na thoni kur keni dëgjuar për
15 herë të parë lidhur me shtabin e UÇK-së në Malishevë?

16 PË. Në lidhje me shtabin e UÇK-së në Malishevë kam dëgjuar po
17 ato tre ditë. Në ditën e parë që kam udhëtuar me Gani
18 Krasniqin për në Likovc, Rezallë edhe Plluzhinë sepse ka qenë
19 dashtë të kaloj në atë territor.

20 PY. Faleminderit. Si keni dëgjuar lidhur me këtë, Dëshmitar?

21 PË. Po veç i kam parë ushtarët edhe me automat në atë kohë
22 nëpër Malishevë.

23 PY. A e dini se kur është formuar?

24 PË. Unë thashë që unë për herë të parë 11, 12 ose 13 mars kam
25 udhëtuar në Malishevë për t’u takuar me Gani Krasniqin dhe

1 gjatë takimit tim aty i kam parë dhe ushtarët të tjerë, por
2 nuk i kam njohur. A Gani Krasniqin e kam njoftur qysh prej
3 viteve 1993, 1994.

4 PY. Faleminderit. Përveç që keni shkuar atje dhe keni parë
5 ushtarët, a mund të na thoni në qoftë se keni shkuar
6 ndonjëherë dhe keni vizituar shtabin e Malishevës së UÇK-së,
7 keni shkuar ndonjëherë për ta vizituar këtë shtab, Dëshmitar?
8 PË. Pas disa herë të shkuarjes time dhe takimit me Gani
9 Krasnqit, pas disa herë shkuarjes time në Likocv, Plluzhinë
10 edhe Rezallë, jam takuar edhe një, në një shitore afër aty
11 qendrës ku kanë qenë të tubuar një njësit i tynve.

12 PY. A e keni vizituar ndonjëherë shtabin e Malishevës?

13 PË. Nuk e di a ka qenë shtab apo ka qenë vetëm grupimi i
14 atyne ushtarëve, po unë ju kam thënë që unë e kam vizituar një
15 grup njerëzish që unë kam menduar që janë ushtarët e UÇK-së. A
16 ka qenë shtabi, a kanë qenë ushtarë të thjeshtë, unë nuk e di.

17 PY. Tani do vazhdojmë me Drenocin, me shtabin e Drenocit dhe
18 njohuritë që keni ju lidhur me të. A mund të na thoni se kur
19 keni dëgjuar për herë të parë për shtabin e Drenocit të UÇK-
20 së, Dëshmitar?

21 PË. Për shtabin e Drenocit kam dëgjuar ende sa kam qenë edhe
22 në shtabin e Likocit si ndihmës me ndihma. Dhe menjëherë unë
23 kam qenë i interesuar pastaj të ndahem prej Likocit dhe të
24 vijë të ndihmoj shtabit të Drenocit sepse shtabi i Drenocit
25 është shtabi i qytetit tim, shtabi i komunës time.

1 PY. Si keni dëgjuar lidhur me këtë?

2 PË. Shumë lehtë. Atëherë kur ka dalë shtabi i Drenovcit veç
3 UÇK-ja ka qenë e përhapur nëpër shumë zona. Dhe fshati është 5
4 kilometra prej meje dhe aty kemi miqësi, kemi shokë, kemi
5 udhëtarë që kanë vizituar ende banorët e fshatit që kanë
6 vizituar shpesh edhe qytetin tim, Rahovecin tim dhe aty ka
7 qenë e pamundur të mos njoftohen të gjithë jo vetëm Ismet Tara
8 si ndihmës veç një muaj e kusur në Likovc, Plluzhinë edhe
9 Rezallë.

10 PY. Kur ka qenë hera e parë që keni shkuar në shtabin e
11 Drenovcit? Ju kujtohet, Dëshmitar?

12 PË. Hera e parë menjëherë mbas daljes dy ose tre ditë më së
13 shumti.

14 PY. A e dini, pak a shumë, se në çfarë periudhe ka qenë? A
15 mund të na jepni ndonjë datë të përafërt, Dëshmitar, nëse ju
16 kujtohet?

17 PË. Kjo duhet me qenë në muajin prill, diku në muajin prill.

18 PY. Ka qenë drejt fundit apo drejt fillimit të prillit?

19 PË. Diku prej mesit, prej mesit të prillit, ka fundi i
20 prillit, mesa njohuri që kam, sepse nuk i kam shënuar datat
21 asnjëherë.

22 PY. Është në rregull. A mund të na thoni se kërkoj keni
23 takuar në shtabin e Drenocit?

24 PË. Do për herën e parë apo do përshkrimin në detal për të
25 gjitha?

1 PY. Jo, nuk më duhet që të kem informacion për çdo takim që
2 keni pas, por dua të di se kënd në shtabin e Drenovcit keni
3 takuar?

4 PË. Herën e parë kur kam shkuar në shtabin e Drenovcit kam
5 qenë i ndalur prej ushtarëve, të cilët kanë qenë në maska në
6 një pikë 1 kilometër se para hyrjes në Drenovc. Dhe aty kanë
7 pyetur ata ushtarë se "Ku po shkon?". I kam treguar që dua t'i
8 ndihmoj shtabit të Drenovcit me ndihma tash të Rahovecit,
9 qytetit të Rahovecit, të miat, të babit tim dhe të popullatës
10 të cilët janë grumbulluar për ndihma ushtarëve të UÇK-së.

11 PY. Ku ju drejtuan ushtarët juve, Dëshmitar?

12 PË. Ushtarët kanë thirrur një herë në Drenovc dhe më kanë
13 njoftuar se duhet të marrin lejen e komandantit për të shkuar
14 unë në vizitë për herë të parë.

15 PY. A ju treguan ata se kush ishte komandanti i tyre?

16 PË. Pastaj unë kam mësuar, se dhe jam takuar, ka qenë Xhemë
17 Gashi.

18 PY. A kishte ndonjë nofkë ai?

19 PË. Po, pastaj më vonë e kam mësuar pas disa herëve, Xhemë
20 Gashi ose Gjermani.

21 PY. Në rregull. Sa shpesh keni shkuar ju në shtabin e
22 Drenocit?

23 PË. Në shtabin e Drenovcit kam shkuar ndoshta dhe tre herë,
24 katër herë, sa kam pas ndihma t'i çoj qaq herë kam shkuar se
25 ajo është 5 kilometër mu ka dash pesë ose dhjetë minuta të

1 udhëtoj prej qytetit tim deri në fshatin Drenovc. Sa herë që
2 kam pasur ndihma qaq herë kam shkuar.

3 PY. Faleminderit. Ku ka qenë i stacionuar shtabi, në ça vendi
4 ka qenë shtabi?

5 PË. Shtabi në fillim ka qenë në shtëpitë private kur jam
6 takuar unë me Xhemë Gashin. Pastaj më vonë diku është marrë
7 një kooperativë në dalje të Drenovcit në drejtim Kasenovci dhe
8 në pjesën që ngjitet ka mali i Zatriqit.

9 PY. Faleminderit. Përveç Xhemë Gashit, kush tjetër ka qenë në
10 komandën e shtabit të Drenovcit, mesa keni dijeni ju?

11 PË. Pastaj diku më vonë kam dëgjuar ose më vonë edhe ka
12 ardhur, nuk e di, ka ardhur si shef i shtabit Mahir Hasani.

13 PY. Po ndonjë person tjetër?

14 PË. Aty jam takuar edhe me njerëz që nuk kam dit që janë
15 anëtarë të shtabit, po kam takuar edhe njerëz të tjerë. Kam
16 takuar Mensur Zyberin. Mensur Zyberin ose Pesqindshi që gjatë
17 takimeve të mia kur kanë qenë në prezencë të komandant Xhemë
18 Gashit ose dhe të Mahir Hasanit, kam kuptuar që është një
19 person i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm në UÇK në
20 fshatin Drenovc.

21 Kam takuar pastaj edhe Jusuf Gashin.

22 PY. Një çast, Dëshmitar. Çfarë ju bëri ju të kuptonit se
23 Mensur Zyberaj kishte luajtur një rol të rëndësishëm?

24 PË. Sepse shpeshherë e kam parë duke biseduar me këta
25 komandantin, me shefin e shtabit dhe kam parë që ata kanë

1 respekt për atë.

2 PY. Përmendët edhe Jusuf Gashin. Çfarë roli ka pas ai e dini
3 ju?

4 PË. Nuk e di. Nuk e di çfarë roli ka pas, po ka qenë njeriu
5 ma i vjetër dhe i respektuar në atë fshat.

6 PY. Kur keni ndaluar së çuari furnizime për shtabin e
7 Drenovcit?

8 PË. Shtabit i Drenovcit i kemi ndaluar furnizimet menjëherë
9 në daljen në shtabin e Rahovecit, Arti.

10 PY. Shtabi që përmendët që thatë shtabi i Rahovecit, a njifet
11 me ndonjë emër tjetër përveçse shtabi i Rahovecit?

12 PË. Shtabi Arti i Rahovecit.

13 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj disa pyetje të tjera
14 lidhur me këtë. Kur është krijuar shtabi Arti?

15 PË. Shtabi Arti ë krijuar diku ka mesi i muajit maj 1998.

16 PY. A e dini kush e ka krijuar atë?

17 PË. Po. Komandant Toni, komandant Mici, komandant Piktori dhe
18 Ismet Tara që është prezent para juve këtu.

19 PY. Faleminderit. A mund të na tregoni se si i kanë pasur
20 emrat e plotë Toni, Mici dhe Piktori?

21 PË. Xhelal Hajda, Toni, Selajdin Mullabazi, Mici dhe Gëzim
22 Hamza, Piktori. Dhe Ismet Tara, Hoxha në këtë pikë tash këtu
23 që flas për shtabin Arti.

24 PY. Faleminderit. Përpara sesa të bashkoheshit në njësitin
25 Arti, ndonjëri prej tyre a ka qenë pjesë e ndonjë njësi

1 tjetër, Dëshmitar?

2 PË. Të tretë këta kanë qenë pjesëtarë të njësitit të
3 Drenovcit.

4 PY. Faleminderit. Po Toni, përveç njësitit të Drenocit, a ka
5 qenë anëtar i ndonjë njësiti tjetër ai në atë kohë?

6 PË. Po, ka qenë anëtar i njësitit të Dukagjinit të Ramush
7 Haradinajt, gjeneral Ramush Haradinaj.

8 PY. Në Drenoc kush ka qenë komandant i Tonit, Micit dhe
9 Piktorit?

10 PË. Ata që i përmenda më parë në shtabin e Drenovcit, Xhemë
11 Gashi dhe Mahir Hasani.

12 PY. Faleminderit. A mund të na tregoni se pse është krijuar
13 njësiti Arti?

14 PË. Njësi Arti ë krijuar sepse gjatë kohës së shtabit të
15 Drenovcit në Rahovecin tim, në qytetin tim, kanë ardhur forcat
16 paramilitare policore të cilat kanë bërë krime ndoshta në
17 Kroaci ose ndoshta në Bosnje dhe janë vendosur në hotelin e
18 qytetit tim. Dhe popullata ka qenë e frikësuar me veprimet e
19 tyre dhe ka kërkuar prej neve që të dalim më afër qytetit tonë
20 që të jemi në mbrojtje sa më të mirë të qytetarëve tanë.

21 PY. Faleminderit. Kush komandant i njësitit Arti?

22 PË. Komandanti i njësitit Arti ka qenë Toni, Xhelal Hajda,
23 Toni.

24 PY. Po zëvendëskomandant kush ka qenë?

25 PË. Zëvendëskomandant ka qenë Selajdin Mullabazi, Mici.

1 PY. Po shef i shtabit kush ka qenë?

2 PË. Shef i shtabit ka qenë Gëzim Hamza, Piktori.

3 PY. A i keni respektuar komandantët ju, Dëshmitar?

4 PË. Sikurse vëllezër kemi qenë deri në fund të vdekjes së
5 atyre.

6 PY. Kur ata ju kanë kërkuar ju të bëni diçka, a i bënit juve
7 realitet urdhrat e tyre?

8 PË. Të gjitha brenda mundësive të mia.

9 PY. Faleminderit. Ku e ka pasur shtabin njësitit Arti?

10 PË. Shtabin njësitit Arti e ka pas në dalje të Rahovecit, në
11 pikën që edhe sot ekzistojnë dy stalla të dhenve që dhe
12 atëherë kanë qenë stallat e dhenve, ala pa hi na, po edhe sot
13 janë kthyer prapë në stalla të dhenve për fat të keq.

14 PY. Nuk jam e sigurtë në qoftë se ishte i plotë përkthimi.
15 Mund ta thuash dhe një herë? Dëshmitar, a mund të na shpjegoni
16 ekzaktësisht se ku gjendej ose ku ndodhej njësitit Arti,
17 Dëshmitar?

18 PË. Dalja prej qytetit të Rahovecit ka Drenovci është një
19 rreth që të çon ka Malisheva, Drenovci dhe te poshtë ka
20 Bellacërka dhe Xërxa, në atë kryqin rrugës për në Malishevë
21 është nja 2 kilometra në anën e majtë në një gropë përfundi
22 një bjeshke.

23 PY. Përmendët gjithashtu edhe një ahur. Ça ahuri?

24 PË. Stallë e dhenve .

25 PY. Ça stalle?

1 PË. Dhen. Bagëtia ku mbahet.

2 PY. Sa anëtarë të UÇK-së kishte njësitit Arti?

3 PË. Për herë të parë kemi shkuar nja 20, 25 ushtarë dhe
4 pastaj numër më të madh të ushtarëve që kanë mbërrit shtabi
5 Arti i Rahovecit është diku 170 deri në 180 ushtarë.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani të
8 paraqesë në ekran dokumentin ERN U001-8192 deri në 001-8197
9 dhe përkthimin në anglisht të këtij dokumenti.

10 PY. A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument përpara një
11 jave, Dëshmitar?

12 PË. E kam parë me juve gjatë shqyrtimit, gjatë përgatitjes
13 time me juve. Por edhe e kam parë edhe në --

14 PY. Një çast ju lutem.

15 PË. Edhe një përgjigje kam. Këtë dokument e kam parë edhe në
16 1990 gjatë intervistave të mia të para në grupin e famshëm të
17 gjykatësve dhe të hetuesve të mi të cilët veç ndihem i
18 shqetësuar që janë këtu tash para juve.

19 PY. E keni fjalën për 2019?

20 PË. 2019, po.

21 PY. A i njihni personat në këtë listë, Dëshmitar? Nëse keni
22 problem ose nuk i lexoni dot emrat, mund t'ju lexoj unë,
23 Dëshmitar?

24 PË. Jo. Shumicën e këtyrve i njoh.

25 PY. Mesa dini ju, cilit njësit i përkisnin këta persona? E

1 kam fjalën për personat që ju njihni.

2 PË. Për njësitin nuk e di, mirëpo grupi i Lahit ose Abdulla
3 Bugarit, përndryshe me emër të plotë, ka qenë në fillim si
4 sigurues i pikës ku e kemi pas mbrojtjen e parë për në shtabin
5 Arti, mbrojtjen e parë të shtabit Arti.

6 PY. Ky grup a është pjesë e njësitit Arti?

7 PË. Po.

8 PY. Faleminderit. Mesa keni dijeni ju, përmendët Abdulla
9 Bugarin. Abdulla Bugari ka qenë drejtuesi i grupit Lahi?

10 PË. Si mbas asaj që unë kam mund të kuptoj, sepse ai ka bërë
11 ndërrimin e disa ushtarëve në pikë, aty edhe e kam kuptuar. Se
12 përndryshe unë në shtabin Arti kam qenë shtabin Arti kam qenë
13 shef i logjistikës dhe shef i financave.

14 PY. Faleminderit. Do kalojmë tek kjo pikë për pak.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kalojmë tek faqja e
16 dytë e këtij dokumenti. Do i kërkoja Sekretarit ta zmadhojë
17 pak dokumentin në shqip në veçanti.

18 DËSHMITARI: Po shifet. Po shifet, nuk ka nevojë.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

20 PY. A i njihni këta persona dhe a e dini se cilit shtabe i
21 kanë përkitur ata?

22 PË. Janë persona të shtabit Arti, shtabit Tonit, Micit,
23 Gëzimit dhe komandant Hoxhës pastaj në fund pas lufte.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë më poshtë në dokument

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 27

1 ku jepet komanduesi.

2 PY. Me sa keni dijeni ju, Dëshmitar, Myhedin Isma a ka qenë
3 pjesë e grupit Genci?

4 PË. Po. Edhe ki njësoj sikurse edhe Lahi ose Abdullah Bugari,
5 ka qenë përgjegjës i cili edhe ky me ndërrime, ndrojshin dhe
6 sigurojshin këtë pikë të sigurimit të komandës të shtabit ish-
7 Arti të UÇK-së.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen tjetër.

9 PY. A i njihni këto emra? Pyetja e parë. Dhe pyetja e dytë, a
10 e dini në qoftë se ata i përkisnin ndonjë njësitit të UÇK-së,
11 Dëshmitar?

12 PË. Shumicën edhe këtyrve ushtarëve i njoh edhe sot e kësaj
13 dite. Dhe po një farë Bashkim Mezini, me siguri edhe ai ka
14 qenë, po mu nuk më kujtohet si ushtar i shtabit Arti. Po si
15 grup nuk e njoh, si grup i Luanit nuk e njoh.

16 PY. A e dini në qoftë se ata i përkisnin shtabit të UÇK-së
17 dhe, në qoftë se po, cilit shtabi?

18 PË. Shtabit Arti të Rahovecit.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

20 PY. Po këta persona që keni në këtë listë, a e dini se cilit
21 shtab i përkisnin, Dëshmitar?

22 PË. Janë të shtabit Arti të Rahovecit.

23 PY. Faleminderit.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

25 PY. E njëjta pyetje edhe për këto emra që shikoni në ekran. A

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 28

1 e dini se cilit shtabi i përkisnin këta emra?

2 PË. Edhe këta janë të shtabit Arti.

3 PY. Faleminderit.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
5 dokument të pranohet në provë gjyqësore.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
7 kundërshtim për dokumentin?

8 Z. DIXON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Kemi një
9 kundërshtim të vazhdueshëm për këto dokumente të cilat nuk
10 janë dokumente që janë prodhuar prej dëshmitarit. Pra,
11 dëshmitari mund të pyetet lidhur me emrat, megjithatë ai nuk
12 mund të dëshmojë sa i takon, le të themi, vërtetësisë së këtij
13 dokumenti, për këtë arsye ne kundërshtojmë, mendojmë që
14 dokumenti nuk duhet të pranohet.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
16 pranohet sepse është dhënë konteksti i nevojshëm për
17 dokumentin dhe përmbushen kriteret *prima facie*, për këtë arsye
18 do të pranohet sipas rregullës 138.

19 Dokumenti me ERN 001-8192 deri në 001-8197 do të pranohet
20 në prova gjyqësore.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës. Do të marrë numrin e provës P02076. Aktualisht është
23 i klasifikuar si konfidencial.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Tani të kalojmë tek
25 dokumenti ERN U000-6735 deri në U000-6739. Le ta shohim në

1 ekran këtë dokument. Të kalojmë tek faqja tjetër në shqip.

2 PY. A ju kujtohet që e keni parë këtë dokument përpara një
3 jave, Dëshmitar?

4 PË. Po, znj. Prokurore.

5 PY. A i njihni emrat në këtë listë?

6 PË. Shumicën duhet t'i njoh. Po unë prapë ju kam thënë që unë
7 nuk kam pas lidhje me ushtarët dhe me komandën mes tyre. Po
8 shumicën e ushtarëve të shtabit Arti i kam njoftur dhe i njof
9 edhe sot e kësaj dite, po nuk mund, nuk mund të them që unë i
10 njof të gjithë ushtarët sepse unë nuk kam qenë i lidhur
11 drejtpërdrejt me ushtarët, si shef i logjistikës dhe shef i
12 financave.

13 PY. Po, faleminderit. Emrat që i njihni nga kjo listë, a janë
14 anëtarë të shtabit të Artit, të njësitit Arti?

15 PË. Këto janë shënime të profesorit tim të nderuar Sabahajdin
16 Cena, i cili ia ka pranuar çdo ushtar në datën e pranimit, në
17 ditën të regjistruar, në shënimet e lindjes, me të gjitha
18 njësoj. Dhe unë nuk dyshoj që këtu ka ndonjë gabim sepse ai më
19 duket që i ka regjistruar ashtu siç kanë ardhur. Dhe unë
20 shumicën e njoh, por nuk mund të dëshmojë për çdokënd. Në
21 qoftë se më duhet t'i shikoj, ndoshta mund t'i dalloj, po nuk
22 kam njohuri. Mirëpo për shumicën, për shumicën e ushtarëve di
23 që kanë qenë dhe nuk dyshoj në pavërtetësinë e profesorit tim
24 të nderuar, Sabahajdin Cenaj.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
2 pranohet në prova gjyqësore ky dokument.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtim? Përderisa nuk ka kundërshtim, dokumenti U000-6735
5 deri un U000-6739 pranohet në provë gjyqësore.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do pranohet dhe do marrë
7 numrin e provës P02077. Dhe klasifikimi është konfidencial.
8 Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
10 ju.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kërkoj që të paraqitet në
12 ekran dokumenti me numër SPOE00227439 deri në SPOE00227430.

13 DËSHMITARI: Të rritet edhe --

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

15 PY. A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument?

16 PË. Të rritet edhe pak dokumenti.

17 PY. Mirë.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Përqendrohu tek e djathta, tek
19 shqipja, ju lutem.

20 DËSHMITARI: Qartë, qartë. Vetëm se të rritet. Mirë është.
21 Mirë është.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë që shqipja të
23 duket e plotë.

24 DËSHMITARI: Mirë është. Mirë është. Mirë është.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

1 PY. A ju kujtohet që e patë këtë dokument javën e shkume?

2 PË. Po.

3 PY. Ky dokument është një shënim për Asllan Kleçkën?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe thotë se ka qenë anëtar i njësitit Arti dhe ka qenë

6 në kontrollin e "forcave tona". A ju kujtohet ta keni

7 diskutuar këtë çështje me ndonjë person në njësitin Arti?

8 PË. A profesori më ka lajmëruar, ka lajmëruar për këtë

9 dokument, po unë nuk kam qenë prezent gjatë shënimit të këtij
10 dokumenti. Dhe e kemi biseduar në lidhje me këtë çështje.

11 PY. Çfarë të tha profesori ty?

12 PË. Profesori më ka treguar që ka qenë dashtë të përcaktojë
13 një njohje për Asllan Kleçkën sepse dikush në shtab ka pas një
14 arsye të dyshojë pak për përfshirjen e tij si ushtar i UÇK-së
15 në shtabin Arti.

16 PY. Pse kishte dyshime, pse ishin këto dyshime?

17 PË. Unë nuk e di pse, po kam menduar që mos ka njohuri më
18 ndonjë polic ose me ndonjë serb të qytetit të Rahovecit. Këto
19 janë mendimet e mia personale.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

21 PY. Në këtë faqe thuhet që fëmijët e tij ishin po ashtu pjesë
22 e UÇK-së. Mesa di ti, djemtë e Asllan Kleçkës a ishin pjesë e
23 UÇK-së?

24 PË. Po.

25 PY. Faleminderit. I shihni emrat në fund, Sabahajdin Cena dhe

1 Ismet Tara, i shef?

2 PË. Po.

3 PY. Ti përmende profesorin.

4 PË. Po.

5 PY. Profesori është ky Sabahajdin Cena?

6 PË. Po.

7 PY. A e ke idenë pse u dërgua në Likoc ky dokument?

8 PË. Unë nuk e kam ditur dhe nuk e di as sot ku është dërguar,
9 a është dërguar apo nuk është dërguar as atëherë, as sot e
10 kësaj dite. Unë nuk e di se a është dërgu dhe ku do të
11 dërgohej.

12 PY. Në fakt, unë po ju pyes, a e di ti pse shohim Likoc këtu,
13 pse është shkruajtur Likoc këtu?

14 PË. Pse është shkruar atë ka qenë dashtë ta pyesni profesorin
15 Sabahajdin Cena derisa ka qenë gjallë dhe ka qenë nën
16 intervistimin tuaj sepse ai e ka përpiluar këtë njohuri.

17 PY. Përgjigjen, po ju pyes tani. E di, po tani e di
18 përgjigjen?

19 PË. Jo.

20 PY. A mban mend që këtë pyetje ta bëra dhe javën e kaluar
21 gjatë seancës përgatitore?

22 PË. Po.

23 PY. A të kujtohet çfarë përgjigje më dhe, flasim për këtë
24 dokumentin e Likocit, për këtë dokument, a të kujtohet çfarë
25 përgjigje më dhe?

1 PË. Po. Ju kam njoftuar se kam qenë i njoftuar për këtë
2 dokument dhe ma tutje nuk e di çka dhe ku është dërguar. Të
3 njëjtën përgjigje sikurse që ju jap tash. Ose, ose jipni
4 kuptimin ose jipni kuptimin e pyetjes tuaj pak më, më
5 detaisht. Përpiloni pyetjen në mënyrë tjetër për ta kuptuar
6 unë pak.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
8 tregoj dëshmitarit një deklaratë që ka dhënë më përpara në
9 bazë me rregullën 143(2).

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem vendosim në ekran
12 materialin me numër 125903-125933, PDF faqja 23. Shohim
13 paragrafin 127.

14 PY. Sipas këtij teksti ti ke thënë:

15 "Letra u drejtua Likocit sepse shtabi kryesor i UÇK-së
16 ishte atje. Në atë kohë të gjithë e dinin këtë, kur themi të
17 gjithë, data 17 korrik 1998."

18 A është kjo ajo që keni thënë ju?

19 PË. Jo. Me keni pyetur për emrin Syla që është i shkruar
20 anash, ju kam thënë që me emër Syla e kam njoft këtë personin -
21 -

22 PY. Z. Tara.

23 PË. Po.

24 PY. Z. Tara?

25 PË. Urdhnoni.

1 PY. Z. Tara, do t'ju pyesim dhe për këtë. Po unë tani dua të
2 di prej jush këtë, kjo që thuhet në këtë paragraf këtu, faktin
3 që letra ju drejtua Likovcit a është e saktë?

4 PË. Unë --

5 PY. Dhe këtu ke thënë, këtu sipas këtij teksti ke thënë:

6 "Letra u drejtua Likovcit sepse shtabi kryesor i UÇK-së
7 ishte atje."

8 A është një pasqyrim i saktë i dëshmisë suaj kjo që
9 thashë?

10 PË. Jo, nuk është ashtu. Unë e di që është shkruar për dikën,
11 po për kënd dhe ku do të shkoj ky dokument nuk e kanë
12 përcaktuar as shtabi. Ah, është e ditur që shtabi, kam thënë
13 që shtabi i Likovcit është ditur në atë kohë që ekziston si
14 shtabi i Likovcit. Mirëpo unë nuk e kam thënë që ka shkuar në
15 shtabin e Likovcit. Të jemi të qartë. Sepse kështu kanë qenë
16 edhe shumë -- vetëm pak tash, dua një sqarim për Gjykatësit.

17 Sepse në pyetjet e mia edhe 2019 përkthimet e mia kanë
18 qenë shumë konfuze që unë së bashku me Prokuroren time i kam
19 përmirësuar. Kam kërkuar në anglisht drejtpërdrejt prej
20 përkthyeses teme të përkthehen që nuk janë përputhur fare me
21 gjuhën shqipe të përkthimit në ato intervistat e mia. Dhe mos
22 më bëni prapë njësoj sikurse në 2019. Unë e kam njoftuar dhe
23 jam gjendje dhe, hiç pa përpunimin e pa punën me prokuror, unë
24 t'i përgjigjem edhe drejtpërdrejt çdo prokurori. Sepse unë e
25 kam thënë të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe dua ta them të

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 35

1 vërtetën dhe vetëm të vërtetën.

2 PY. Faleminderit.

3 PË. Nuk e kam thënë çka është --

4 PY. Faleminderit. Faleminderit, z. Tara. Faleminderit.

5 PY. Është e qartë.

6 PË. Okej.

7 PY. E qartë. U regjistrua kjo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të

9 bëjmë një pushim të shkurtër.

10 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim, dhjetë. Mirë?

11 Dhe do kthehemi prapë në sallën e gjyqit.

12 DËSHMITARI: Unë kam një kërkesë për Gjyqtarin. Unë kam
13 një kërkesë për Gjyqtarin para se të dal prej këtujt. Unë pas
14 kësaj dëshiroj, unë pas kësaj dëshiroj prej Gjykatësit, prej
15 Gjyqtarit të më paraqitet dokumenti im në të cilin unë kam
16 ngritur dyshimet e mia në lidhje me intervistimet e mia të
17 investiguesve, prokurorëve të mi në 2019, përndryshe prej
18 kësaj unë, prej këtij momenti unë nuk --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të fikëm
20 mikrofonin. E fikëm mikrofonin. Ju lutem dëgjoni. Nuk do ta
21 bëjmë këtë gjë sot.

22 DËSHMITARI: Atëherë --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot përgjigju
24 pyetjeve, z. Tara. Kur të përfundosh me dëshminë do ta japim
25 mundësinë që të bësh një deklaratë. Ju lutem dilni tani nga

1 salla sepse do bëjmë dhjetë minuta pushim.

2 DËSHMITARI: Unë nuk do të flas prej këtij momenti më
3 asgjë. Mund të kërkonj ju çdo gjë. Por unë prej këtij momenti
4 në qoftë se ai dokument që ka ngritë shqetësimin timin, që ka
5 rrezikuar jetën time dhe të dhjetë familjarëve të mi dhe që mu
6 në atë dokument jam përshkruar si tradhtar i kombit tim,
7 tradhtar i UÇK-së, tradhtar i dëshmorëve dhe heronjve të mi
8 dhe të gjithë atynve, asaj popullate të masakruar dhe të
9 larguar nga Kosova, unë nuk do të japi asnjë njohuri pa u
10 shqyrtuar ky dokument dhe pa u pastruar komandant Hoxha, ta
11 dini që prej këtij momentit nuk do të flas asgjë. Mund të më
12 thirrni. Seanca do të mbyllet që këtu ose do të vazhdoni, unë
13 asnjë përgjigje nuk do të jap derisa të shqyrtohet ky dokument
14 --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mikrofoli
16 juaj është i fikur, z. Tara.

17 DËSHMITARI: Nuk e kam problem a e ndëgjoni, s'e ndëgjoni.
18 Po unë ju njoftoj që unë nuk do të përgjigjem më --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
20 dilni nga salla.

21 DËSHMITARI: Okej.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhjetë minuta
24 pushim.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 10.12

1 --- Seanca rifillon në orën 10.22

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
3 dëshmitarin, ju lutem.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Na dëgjon, Dëshmitar? Z. Tara, na dëgjon? Dëgjon, z.

7 Tara?

8 DËSHMITARI: Po, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, ju
10 lutem, e kuptojmë për çfarë dokumenti po flisni, e kuptojmë që
11 doni të thoni diçka për këto dokumente. Do t'i japi Prokurorja
12 dokumentet, por prisni momentin, ju lutem. Bëni pak durim.
13 Këtu keni ardh si Dëshmitar, këtu keni ardhur për të dhënë
14 përgjigje. Keni detyrimin për të dhënë, thënë të vërtetën.

15 Kur të flasim për këtë dokumentin, do kalojmë në seancë
16 private. Në rregull? Që të mbrojmë familjen tuaj dhe t'ju
17 mbrojmë ju. Në qoftë se ju mendoni që është e rëndësishme.
18 Por, ju lutem, të vazhdojmë tani me pyetjet dhe do t'ju japim
19 mundësinë ta shihni dokumentin kur të vijë çasti i duhur.

20 A mund të vazhdojmë, z. Tara? A kuptoni këtë?

21 DËSHMITARI: Jo. Unë nuk do të përgjigjem asgjë derisa nuk
22 bëhet njoftimi haptazi, jo në seancë të mbyllur, të dëgjojnë
23 edhe popullata ime, edhe ushtarët e mi, edhe bashkëluftëtarët
24 e mi, të cilët të gjithë na njohin. Nuk flas asgjë. Unë
25 përgjigjet e mia i -- z. Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
2 problem.

3 DËSHMITARI: Z. Gjykatës, vetëm njoftimin. Vetëm
4 njoftimin. Përgjigjet e mia unë i kam dhanë. Prokurores --
5 [Mikrofoni çaktivizuar].

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara. Ju
7 lutem, duhet të vazhdojmë me pyetjet. Nëse do të jesh në
8 seancë publike, s'ka problem fare, në seancë publike rrimë.
9 Unë ta dhashë si mundësi, po deshe.

10 Ne duhet të vazhdojmë tani. Jeni i detyruar t'u
11 përgjigjeni pyetjeve. Do japim urdhër për këtë.

12 DËSHMITARI: Unë përgjigjet e mia --
13 [Folës që flasin njëkohësisht].

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e keni
15 alternativë tjetër.

16 DËSHMITARI: Përgjigjet e mia i kam dhanë, z. Gjykatës,
17 Prokurores, dhe përgjigjet e mia i kam dhanë në 2019. Të
18 gjithë atyneve hetuesve të mi dhe i qëndroj mbrapa, por pa u
19 shqyrtuar ky dokument, unë nuk flas.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, nuk
21 i kemi dëgjuar ne këtë. Nuk kemi qenë në ato takime. Ne duam
22 të marrim përgjigjet tuaja. Na e shpjegoni ju me përgjigjet
23 tuaja. Ne duhet ta dëgjojmë këto prej jush. Ne nuk do të
24 mbështetemi në diçka që ka ndodhur para shumë vitesh. Ne duam
25 ta dëgjojmë këtë nga goja juaj sot. Është shumë e rëndësishme

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 39

1 kjo. Është e rëndësishme për ne të kuptojmë pozicionin tuaj,
2 z. Tara.

3 DËSHMITARI: Ju do t'i dëgjoni të gjitha, të gjitha të
4 mijat çka do të më pyesni rreth diturive të mia, por mbas
5 shqyrtimit të këtij problemi tim, që është jetik, që më ka
6 rrezikuar nderin tim kombëtar, dhe familjen time
7 dhjetë-anëtarëshe, z. Gjykatës. Ju do t'i dëgjoni përgjigjet e
8 mia të gjitha mbas shqyrtimit të këtij problemi të ngritur
9 tim, shqetësimit tim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si propozon
11 Prokuroria, atëherë?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I jap fjalën Dëshmitarit që do ia
13 tregojmë dokumentin, kur të vijë momenti. Por vazhdojmë siç e
14 kishim planifikuar seancën me pyetjet. Të jap fjalën,
15 Dëshmitar, që do ta jap, do ta tregoj dokumentin dhe të jap
16 mundësinë që të komentosh.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet t'i
18 ndjekim agjendën e ditës, duhet të ndjekim orarin, z.
19 Dëshmitar. E kuptoni? Po flasim për vitin 1998 tani. Ju lutem,
20 përgjigjuni këtyre pyetjeve siç i kishim planifikuar ne dhe
21 pastaj do flasim për dokumentin tuaj që ta komentosh apo të
22 bësh korrigjimet që ke nevojë.

23 DËSHMITARI: z. Gjykatës. Unë për hir të juaj që jeni të
24 gjithë prezentë kam pranuar të flas deri më tash. Por të
25 njëjtën ia kam bërë me dije në, Prokurores time se unë nuk do

1 të flas fare derisa që nuk shqyrtohet ai problem.

2 Mirëpo kam bërë, t'ju bëj të ditur që unë jam në gjendje
3 të përgjigjem çdo pyetje të juaj, por pas hapjes së këtij
4 dokumentit. Pas diskutimit të këtij dokumenti. Se çka kanë
5 bërë ata ish-hetues të mi, që unë për vete e quaj, në qoftë se
6 ato janë shënimet e tija, kriminel, kriminel hetues. Të cilët
7 më kanë rrezikuar mua, dhjetë anëtarët e familjes time, dhe më
8 kanë shpallur tradhtar të kombit tim një dokument që unë kurrë
9 nuk e kam lexuar, kurrë nuk e kam nënshkruar, dhe kurrë nuk më
10 është paraqitur mua.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, ju
12 jeni këtu që të thoni ato që duhet të thoni. Nëse ti refuzon
13 t'u përgjigjesh pyetjeve, ka procedura të tjera që mund të
14 ndjek Prokuroria për të pranuar deklaratat tuaja, dhe mbase
15 kështu do të pranohet dhe ai dokumenti që ti do të diskutosh.
16 Kështu që është në favorin tuaj të vazhdojmë me pyetjet dhe ta
17 diskutojmë dokumentin për të cilin keni shqetësime në momentin
18 e duhur. Ama në qoftë se ti refuzon të përgjigjesh, atë
19 dokument do ta marrë Trupi Gjykses pa marrë komentet tuaja për
20 dokumentin. Ne do [E pakuptueshme] ta pranojmë pa komentuar ti
21 pastaj. E kupton këtë?

22 DËSHMITARI: Unë dua t'i jap shqetësimet e mia, t'ju
23 njoftoj siç e kam njoftuar edhe Prokuroren time për
24 shqetësimet e mia, dhe ajo ka ndërhyrë disa herë sepse unë e
25 kam ndryshuar vetveten gjatë bisedës me Prokuroren time edhe

1 gjatë marrjes në proponimin tim ose në përgatitjen time për të
2 dalë në seancë të hapur. Unë këtë shqetësim ia kam paraqitur
3 Prokurores time. Unë këtë shqetësim ia kam paraqitur edhe
4 anëtarëve të sigurimit tim fizik, për këtë shqetësim timin
5 shumë të madh. Dhe mos më mundoni.

6 Le të kalojë ky dokumenti dhe unë pastaj do t'ju
7 përgjigjem shumë, shumë shpejt, shumë, shumë lehtë, e të
8 gjitha do të jenë të qarta, z. Gjykatës. Sepse unë nuk mundem,
9 unë s'jam vetvetja ma këtu, pa u shqyrtuar ai dokument.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurorja
11 mund të vazhdojë me pyetjet.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar --

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Fillimisht i lutem Sekretarisë të
15 nxjerrë sërish në ekran dokumentin që po shikonim më herët,
16 dhe është dokumenti ERN SPE00227429.

17 PY. Z. Tara, përpara pushimit ne po shihnim këtë dokument që
18 është në ekran. Në faqen e parë ka një shënim që thuhet këtu
19 "Për Sylën". A e dini ju kush është ky Sylë?

20 PË. Përgjigjen time e keni ju dhe unë nuk flas më. Mos bëni
21 pyetje.

22 PY. Z. Tara, Gjykatësit duhet ta dëgjojnë përgjigjen nga goja
23 juaj tani.

24 PË. Do ta dëgjoj pas shqyrtimit të dokumentit të cilin unë
25 kërkoj të bëhet i ditur për popullin time, se çka po punohet

1 në këtë gjykatë.

2 PY. Z. Tara, siç ua thashë, shumë shpejt do jua tregoj
3 dokumentin. Sa më shpejt t'i përgjigjesh pyetjes, aq më shpejt
4 do shohësh dhe dokumentin. Kështu që vazhdojmë tani që të
5 shkojmë te dokumenti në çastin e duhur. Por ama duhet të
6 përfundojmë këtë temë, dhe disa tema të tjera. Përndryshe, nuk
7 do jemi kurrë të qartë. Ju lutem, përgjigjjuni pyetjes, kush
8 është Syla.

9 PË. Mua më duhet gjysmë ore shqyrtim me atë dokument, pastaj
10 të përgjigjem shumë ma shpejt e shumë ma lehtë, qartësisht.
11 Sikurse jam përgjigjur ndaj çdo pyetjes tande dhe ndaj 32
12 orëve të investigimit tim të hetuesisë time në 2019.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
14 rifreskoj kujtesën Dëshmitarit me një deklaratë të mëparshme.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, vendosim në ekran
17 Shënimin Përgatitor 125903, 125933, dhe shohim faqen 23 në PDF
18 të këtij materiali. Paragrafi 127.

19 PY. Dëshmitar, kur u takuam javën e kaluar, kur ta tregova
20 unë këtë dokumentin, ti the kështu:

21 "Dëshmitari nuk e di kush është Sulltani, por Syla ka
22 qenë shkurtimi i emrit Sylejman Selimi."

23 A është kjo që ke thënë në dëshminë tënde, është
24 pasqyruar saktë?

25 PË. Ju i dini përgjigjet e mia. Unë nuk flas më.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
2 pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtime?

5 Z. DIXON: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin me shkrim
6 dore, apo shënimin përgatitor?

7 E kundërshtojmë pranimin e dokumentit me shkrim dore,
8 sepse dëshmitari nuk po përgjigjet në dëshminë e tij, dhe po
9 thotë që nuk e ka nënshkruar dokumentin. Nuk mund të jetë
10 dokumenti i tij dhe ai nuk di asgjë lidhur me atë çfarë i ka
11 ndodh këtij dokumenti.

12 Ai ka dhënë dëshmi për një incident që ka ndodhur, por
13 nuk ka dhënë asnjë dëshmi që mund të vërtetojë autenticitetin
14 e këtij dokumenti. Kështu që ne kundërshtojmë mbi këto baza
15 pranimin e këtij dokumenti.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua të shtoj dhe unë kundërshtimin
17 që kemi lidhur me sekuestrimin që është bërë. Kontrollimin, më
18 falni.

19 Z. MAIR: [Përkthim] Po ashtu, ne kundërshtojmë pranimin e
20 këtij dokumenti.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i japim
22 një numër provizor.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti është me numër 156, në
24 parashtrimin e protokolluar F02944A-01, në mocionin për prova
25 jогоjore që lidhen me zonën e Pashtrikut.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 44

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër
2 SPOE00227429, SPOE00227430 do të marrë numër provizor, të
3 përkohshëm. Dhe numri që do t'i japim ne është P02078 dhe
4 klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar
6 Gjykatës.

7 PY. Z. Tara, në mënyrë që të sigurohemi që të vazhdojmë pa
8 vonesa, tani do t'ju tregoj një dokument që besoj që është
9 dokumenti për të cilin e keni fjalën, dhe do t'ju bëj pyetje,
10 do t'ju pyes, domethënë, në qoftë se ju kundërshtoni atë çfarë
11 përmban ky dokument, dhe më pas do vazhdojmë.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
13 paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00144632 në të dyja
14 gjuhët.

15 DËSHMITARI: Unë nuk dëgjoj mirë. Volumin edhe pak më --
16 nuk dëgjoj mirë, ose flet shumë ngadalë, shumë pak,
17 Prokurorja.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po tani më
19 dëgjon, Dëshmitar?

20 DËSHMITARI: Yes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
22 Prokurorja do t'ju tregojë dokumentin që ju përmendi. Dëgjon,
23 Dëshmitar?

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju

1 tregohet në ekran dokumenti.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

3 PY. Z. Tara, a është ky dokumenti për të cilin e kishit
4 fjalën ju?

5 PË. Çojeni deri në fund t'i shoh nënshkrimet.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të vazhdojmë ta çojmë deri në
7 fund.

8 PY. Z. Tara --

9 PË. *Please.*

10 PY. -- ky është një shënim -- më dëgjoni, ju lutem. Dëgjoni
11 pyetjen time, do t'ju jepet mundësia, por duhet t'i
12 përgjigjeni pyetjes time. Ky është një shënim i një takimi që
13 keni pasur me një përfaqësues të UNMIK-ut në vitin 2001. A ju
14 kujtohet të keni pasur një takim me një përfaqësues të UNMIK-
15 ut në vitin 2001?

16 PË. Nuk është ky dokumenti që unë e kërkoj. Dhe prej këtuajt
17 nuk i besoj asgjë kësaj Gjykate. Nuk është dokument që unë e
18 kërkoj. Ma keni ndërruar dokumentin. Dokumenti nuk është që
19 unë e kam lexuar, dokumenti është i nënshkruar prej
20 intervistuesve të mij, në vitin 2019, pa dijeninë time, pa
21 nënshkrimin tim dhe pa ma njoftuar dokumentin. Nuk është ky
22 dokument. Këtë dokument keni provuar ju ta ndryshoni, që jam
23 njoftuar më, prej dy siguruesve të mij. Ky dokument nuk është
24 dokumenti që unë e kërkoj, znj. Prokurore.

25 Dhe tash nuk i besoj asgjë më kësaj Gjykate. Dhe nuk flas

1 asgjë. Dokumentin investigues timin të vitit 2019, të
2 nënshkruar nga ish-hetuesit e mi, Prokurorët e mi, për katër
3 ditë me radhë përmbi 32 orë. Përshkrimin gjeneral se çka i kam
4 thënë unë, por pa dijeninë time, pa ma dhanë ta lexoj dhe pa e
5 nënshkruar unë fare. Që më kanë paraqitur mua si tradhtar të
6 kombit tim, tradhtar të UÇK-së dhe tradhtar të dëshmorëve dhe
7 heronjve të mi. Ky është dokument që kurrë nuk ma keni
8 paraqit.

9 Unë kam kërkuar edhe prej juve të më jipni një kopje të
10 atij dokumenti, nuk ma keni dhënë, znj. Prokurore. Kam lypur
11 edhe numrin e regjistruar në këtë dokument, as numrin e
12 dokumentit nuk ma keni dhënë. Dhe unë menjëherë kam dyshuar se
13 ky dokument do të më hupet. Edhe është hupur, në qoftë se
14 paraqitet para meje. Nuk jam unë këtu lojë. Unë kam bërë luftë
15 çlirimtare për popullin tim. Nuk jam unë këtu lojë, dhe as nuk
16 ju frigohem as juve dhe askujt për ato që i kam mbaru.

17 Unë kam dëshmuar 32 orë, dhe jam në gjendje të dëshmoj
18 dhe prapë 32 orë. Unë i kam edhe CD-të e mia që kam marrë më
19 2019 dhe i kam me vete. Vetëm ftoj të më lironi dhe të biem
20 CD-të në qoftë se duhet të hetohen të gjitha prej fillimit,
21 sepse unë as përkthimit të atyne të 2019 nuk i besoj, por
22 CD-të e mia janë me vete, dhe unë i kam prezent këtu, jashtë
23 Gjykatës. Dhe mund t'ju bij incizimet e mia dhe të shihni. Por
24 ky dokument nuk më është treguar, kurrë, kurrë, kurrë mua.

25 E kemi diskutuar këtë dokument, por jo këtë -- [Mikrofoni

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 47

1 çaktivizuar].

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jua ndërpreva
3 përsëri mikrofonin, Dëshmitar, sepse nuk po i përgjigjeni
4 pyetjes.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

6 PY. Z. Tara, mbase do lexoj një pjesë të këtij dokumenti në
7 mënyrë të tillë që t'ju rifreskohet memoria dhe që të flasim
8 në qoftë se ky është dokumenti për të cilin po flasim. Ju
9 lutem, më dëgjoni, z. Tara.

10 PË. Nuk e dua unë, nuk e dua unë këtë dokument. Nuk e dua unë
11 këtë dokument. Nuk e kam problem unë për këtë dokument. Unë
12 kërkoj tjetër dokument. [Mikrofoni çaktivizuar].

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, jua
14 ndërpreva përsëri mikrofonin. Do të duhet që t'i përgjigjeni
15 pyetjeve që ju bëhen. Nuk jeni ju përgjegjës për të zgjedhur
16 pyetjet që ju bëhen. Kur Prokurorja t'ju bëjë pyetje duhet t'i
17 përgjigjeni. Po ashtu duhet që t'i përgjigjeni dhe pyetjeve që
18 do t'ju bëjnë ekipet e Mbrojtjes.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk dua që të ndërpres, por dua
20 të pyes në qoftë se dëshmitari po flet për intervistën me ZPS-
21 në në 2019, që është me 20 pjesë, por që mund të ketë zgjatur
22 32 orë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam
24 përshtypjen që për këtë po pyet dëshmitari.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mirë, do ta pyesim, ta kuptojmë

1 në qoftë se po pyet për këtë dokument apo jo. Për këtë arsye
2 do i kërkoja Sekretarit të paraqesë në ekran transkriptin
3 083217-TR-ET dhe versionin në shqip që është 083217-TR.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Për sqarim, doni ndonjë
5 pjesë të caktuar apo jo?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të fillojmë me pjesën e parë.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Edhe një sqarim tjetër,
8 duhet të tregojmë versionin e rishikuar apo jo?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, ju lutem, versionin e
10 rishikuar.

11 PY. Z. Tara, A ju kujtohet ta keni parë këtë transkript
12 përpara një jave?

13 PË. Çoje deri në fund. Le të mbërritet deri në fund.

14 PY. Z. Tara, ky dokument nuk ka nënshkrim. Është thjesht një
15 zbardhje, një transkript --

16 PË. Nuk është ky dokument që unë e kërkoj. Nuk është ky
17 dokument që unë e kërkoj. Unë di çka kërkoj. Sepse kam kërkuar
18 menjëherë të më jepet kopja e atij dokumentit ose të më jipet
19 numri me të cilin është regjistruar ky dokument. Nuk është ky
20 dokument. Po manipuloni, znj. Prokurore. E dua dokumentin që
21 unë e kam lexuar. Gjysmën pastaj s'kam mundur, e ka lexuar
22 përkthyesja jote, ose përkthyesja ime në gjuhën shqipe
23 gjysmën. Sepse unë nuk kam mundur ta lexoj.

24 PY. Po.

25 PË. A ju kujtohet, znj. Prokurore?

1 PY. Z. Tara, A ju kujtohet -- ju lutem, përgjigjuni pyetjes
2 time. A ju kujtohet që e keni rishikuar këtë deklaratë përpara
3 një jave?

4 PË. Nuk më kujtohet asgjë, kaq. Pa u paraqitur dokumenti im.
5 Pastaj do të më kujtohen të gjitha.

6 PY. A ju kujtohet që ju kam pyetur në qoftë se përfaqësuesi i
7 ZPS-së është sjellë në mënyrë profesionale gjatë intervistës?

8 PË. Unë po ju them dokumentin, pastaj -- se ai dokumenti më
9 duket ka avulluar brenda Gjykatës. Ai dokument që është shumë,
10 shumë i rëndësishëm. Të tregohet se çfarë po bën kjo Gjykatë
11 me çlirimtarët, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, me njollosjen
12 e luftës së UÇK-së. Pastaj mund t'i diskutojmë të gjitha.

13 PY. Z. Tara --

14 PË. Mos më pyetni më, nuk përgjigjem -- [Folës që flasin
15 njëkohësisht] -- vetëm se kur të paraqitet në ekran --

16 PY. Iu përgjigjët pyetjes.

17 PË. -- dokumenti që unë ju kam kërkuar, të më jipet kopje ose
18 të më jipet numri i regjistrimit të atij dokumenti që unë ta
19 kërkoj prej Gjykatësit këtu të paraqitet ai dokument. Kur të
20 ma paraqitni ju e dini për cilin ju shumë e dini për atë
21 dokument, cili dokument është. Pastaj të gjitha vazhdojmë pa
22 kurrfarë problemi.

23 Pa dalë ai dokument nuk kam përgjigje për asgjë.

24 PY. Z. Tara, jua tregova dokumentin më herët dhe më thatë që
25 nuk ishte ai dokumenti. Tani, po ju tregoj ca dokumente të

1 tjera dhe ju thashë "a doni t'jua lexoj", dhe thatë që "nuk
2 doni ta dëgjoni". Tani, do ju tregoj një tjetër deklaratë të
3 mëparshme, Dëshmitar.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kështu që për këtë do i kërkoja
5 Sekretarit që të paraqesë dokumentin me ERN 125903, faqja 3.
6 Ju lutem, të përqendrohemi tek paragrafi 12.

7 PY. Përpara një jave, kur ju pyetëm një pyetje që kishte të
8 bënte me intervistën e 2019, ju keni thënë si më poshtë:

9 "... sipas kësaj interviste të ZPS-së përfaqësuesit e
10 ZPS-së ndonjëherë i kanë ushtruar trysni Dëshmitarit për t'iu
11 përgjigjur një pyetjeje, duke i përsëritur pyetjen, dhe ai më
12 pas i kujton që ka qenë i lodhur gjatë intervistës. Më pas,
13 Dëshmitari vëren që përfaqësuesit e ZPS-së janë sjellë në
14 mënyrë profesionale dhe në mënyrë korrekte gjatë gjithë
15 intervistës dhe ai nuk ka pasur ankesa lidhur me procesin.
16 PË. Nuk dëgjoj mirë.

17 PY. A jeni dakord me këtë, Dëshmitar?

18 PË. Jam dakord kur të jenë përkthyesja ime në shqip që ka
19 lexuar gjysmën e atij dokumenti të më qitet këtu, pastaj të
20 gjitha bëhen -- [Mikrofoni çaktivizuar]. Përkthyesja e ka
21 lexuar dokumentin të cilin --

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast,
23 Dëshmitar. Nuk ju takon juve që të vendosni se cilat janë
24 kushtet për dhënien e dëshmisë tuaj. Ju lutem, dëgjoni pyetjet
25 dhe jepni përgjigje për pyetjet e bëra nga Prokurorja.

1 DËSHMITARI: Nuk jap përgjigje pa u -- nuk jap përgjigje,
2 Gjykatës, ju kam thënë, që nuk jap përgjigje pa m'u paraqitur
3 ai dokument, të cilën gjysmën e kam lexuar unë, gjysmën e ka
4 lexuar përkthyesja ime, sepse unë nuk kam mundur më, sepse kam
5 qajtur duke dëgjuar atë dokument.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dëshmitar, a mund t'ju bëj
7 një pyetje unë?

8 A e kuptoj drejt që ju jeni intervistuar në vitin 2000
9 nga UNMIK-u, dhe në 2001 përsëri nga UNMIK-u. A e kam kuptuar
10 drejt unë këtë, Dëshmitar?

11 DËSHMITARI: Unë nuk jam intervistuar nga UNMIK-u,
12 asnjëherë. Asnjëherë. Atë dokument e pashë që m'u paraqit
13 herën e parë, por unë kërkoj dokumentin tim, dokumentin tim që
14 përkthyesja ime e ka lexuar gjysmën sepse unë nuk kam mundur
15 ta lexoj më. Pa m'u paraqitur ai dokument, unë këtë Gjykatë e
16 shpalli Gjykatë që do me na dënuar neve si komb, si popull
17 shqiptar, edhe si UÇK, edhe si të gjithë. Prej mu nuk jeni më
18 në qoftë se nuk paraqitet ai dokument, ju nuk jeni Gjykatë
19 kredibile për mua.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Tara, dua të kuptoj
21 dokumentin për të cilin po flet, për çfarë dokumenti e keni
22 fjalën? Juve ju kanë intervistuar gjithashtu në vitin 2019 për
23 disa ditë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. A është e
24 saktë kjo, Dëshmitar?

25 DËSHMITARI: Në 2019 po flasim, për Gjykatën Speciale të

1 Hagës?

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

3 DËSHMITARI: A po flet për Gjykatën Speciale të Hagës?

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

5 DËSHMITARI: Katër ditë, 32 orë, më së paku ose 34 orë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po. Z. Tara, dua të kuptoj
7 se për cilin dokument jeni i shqetësuar. Për intervistën e
8 2019, për intervistën e 2001, apo për intervistën e 2000? Na e
9 shpjegoni.

10 DËSHMITARI: Për intervistën e 2019, përshkrimi gjeneral i
11 gjithë atyne hetuesve, prokurorëve të mi, përshkrimin gjeneral
12 pa njoftimin tim se çka krejt kanë zbuluar, çka ka thanë Ismet
13 Tara, por vetëm me dëshirën e tyren. Qysh e kanë -- [Folës që
14 flasin njëkohësisht].

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Tara, ne kemi një
16 transkript prej 470 faqesh të kësaj interviste, dhe nuk kemi
17 kohë që të kalojmë 470 faqe, kështu që duhet që të na ndihmoni
18 që të kuptojmë ekzaktësisht se çfarë problemi keni ju, në
19 mënyrë precize.

20 DËSHMITARI: E di Prokurorja, e din Prokurorja ime sepse
21 unë kam kërkuar menjëherë atë dokument ta kem unë si kopje,
22 ose ta kem numrin e regjistruar të atij dokumenti. Prokurorja
23 ime e din. Ajo e din shumë mirë. Ose përkthyesja ime e cila ka
24 lexuar gjysmë për mu, sepse unë nuk kam mundur as ta lexoj më.
25 Se kam ndier veten që jam tradhtar i kombit tim, tradhtar i

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 53

1 heronjve, i dëshmorëve të mi, tradhtar i UÇK-së time, tradhtar
2 i të gjithë atij gjakut që është derdhur në Kosovë për
3 çlirimin e lirinë e Kosovës. A po kupton, z. Gjykatës? Dhe atë
4 dokument ajo ma ka paraqitur, unë e kam kërkuar dhe kërkoj ta
5 qet tash këtu. Përndryshe, unë nuk kam çka flas dhe nuk i
6 besoj kësaj Gjykate më fare, në qoftë se ai dokument nuk
7 paraqitet.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Iodice, fjala për ju.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mbase mund të bëjmë një përpjekje
10 të fundit, duke i treguar deklaratën e UNMIK-ut.

11 DËSHMITARI: Jo të UNMIK-ut.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

13 PY. Z. Tara,

14 PË. Jo, jo të UNMIK-ut. Mos u mundo. Mos u mundo, znj.

15 Prokurore. Dokumenti që e kam kërkuar unë të më bëhet kopje.

16 Znj. Prokurore, dokumentin që unë ju kam kërkuar të më jepet
17 kopje. Jo dokumentin e UNMIK-ut. Pastaj e diskutojmë.

18 PY. Po, po.

19 PË. Pastaj e diskutojmë dokumentin e UNMIK-ut edhe të gjitha
20 dokumentet që ju i keni. Sepse unë për të gjitha të tjerat jam
21 dakorduar me ju.

22 PY. Z. Tara, do jua tregoj dokumentin gjysmën e së cilës jua
23 ka lexuar përkthyesja.

24 PË. Po.

25 PY. Dhe do t'ju lexoj një pjesë të asaj.

1 PË. Ma paraqit në ekran.

2 PY. Z. Tara, më dëgjoni, ju lutem. Na duhet që të ndjekim një
3 rregull të caktuar për të vijuar.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
5 paraqesë dokumentin SPOE00144632. Të kalojmë tek faqja e dytë,
6 tek gjysma e dytë e faqes. Të kalojmë drejt fundit të faqes.

7 PY. Z. Tara, do t'jua lexoj ngadalë këtë dokument. Ju lutem
8 më ndiqni leximin përmes përkthimit.

9 "Tara pranoi që UÇK-ja kishte kapur civilë që mendoheshin
10 që të ishin bashkëpunëtorë, pavarësisht në qoftë se ata ishin
11 serbë, shqiptarë, romë apo jo. Tara tha që persona u vranë dhe
12 u lanë në vendin e ekzekutimit. Ndonjëherë ata i kanë djegur
13 trupat përndryshe kafshët dhe koha kontribuonin për zhdukjen e
14 provave.

15 "Ai sqaroi që UÇK-ja duhej t'i vriste ata. Në rast lirimi
16 ose largimi i 'burgosuri' do të kishte qenë një provë fizike e
17 asaj që bëri UÇK-ja."

18 A ju kujtohet ta keni dhënë këtë deklaratë, Dëshmitar?

19 PË. Ky dokument nuk po kërkohet prej meje. Kërkohet dokument
20 tjetër. Znj. Prokurore, qitni dokumentin sepse unë ju kam
21 kërkuar juve të gjindet ai dokument. Ky është dokument i
22 UNMIK-ut, që ka dhanë Anna Vannozzi. Ju kam treguar. Dokumenti
23 e dua timin, pastaj të --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht po ju
25 pyet Prokurorja në qoftë se e keni thënë këtë apo jo. A e keni

1 thënë atë pjesën që jua lexoi Prokurorja, e keni thënë, po apo
2 jo?

3 DËSHMITARI: Jo, kurrë. Asnjëherë. Kjo është përpunim i
4 një gazetares që kurrë s'është takuar me mua. Por unë dua
5 dokumentin që ia kam kërkuar Prokurores. Ta paraqet në ekranin
6 tim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara,
8 pyetja që ju bëra ishte kjo, që "A e keni thënë këtë?"
9 Përgjigja që dhatë ishte "Jo", nuk e keni thënë, pra nuk e
10 keni thënë, po apo jo?

11 DËSHMITARI: Kjo e ka thënë Anna Vannozzi, z. Gjykatës,
12 sepse unë di, sepse unë kam qenë në investigimet dhe në
13 përpunimin e, me këta.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e keni
15 thënë ju, e ke thënë ti apo jo? Po apo jo?

16 DËSHMITARI: Këtë dokument e ka thënë dikush tjetër, unë
17 kam thënë --

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kaq është
19 pyetja.

20 DËSHMITARI: -- kurrë nuk është bërë një takim me atë Anna
21 Vannozzi, kurrë, kurrë, kurrë.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
23 lejoni në këtë pikë. Dëshiroj që t'ju ndihmoj. Ekziston një
24 tjetër version i kësaj, në një dokument që i janë shtuar
25 intervistës, dhe versioni që po shikoj unë ka disa nënshkrime

1 në fund të tij. Dhe thjesht po ju sugjeroj në qoftë se ky
2 është dokumenti që i intereson Prokurorisë apo jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo varet nga
4 Prokurorja, Faleminderit që na e bëtë me dije këtë gjë.
5 Megjithatë, Prokurorja vendos.

6 [Mikrofoni çaktivizuar]. Ka ardhur koha për të bërë
7 pushimin e paradites. Do të bëjmë pushim për gjysmë ore,
8 Dëshmitar. Do të bëjmë një pushim për 30 minuta dhe pastaj do
9 kthehemi në orën 11.30 në sallën e gjyqit. Ju lutem, dilni nga
10 salla së bashku me Sekretaren.

11 DËSHMITARI: Vetëm një kërkesë --

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po jua
13 shkëputëm mikrofonin tani.

14 DËSHMITARI: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushim për gjysmë ore.

18 --- Pauza fillon në orën 10.59

19 --- Seanca rifillon në orën 11.31

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
21 vazhdojmë do të nxjerrim një urdhër me gojë. Urdhri me gojë
22 lidhet me arsyet për vendimin që kemi marrë për parashtrimin e
23 protokolluar të Mbrojtjes për dosjet përfundimtare.

24 Më 7 shkurt 2025 Mbrojtja kërkoi që afatet e rregullës
25 134(b) dhe paragrafi 135 për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor të

1 ndryshohen në mënyrë që palët të dorëzojnë dosje gjyqësore një
2 pas një në mënyrë që të respektohet drejtësia e procesit
3 gjyqësor.

4 Mbrojtja kërkon që dosjet t'i dorëzojnë njëra pas tjetrës
5 dhe jo në mënyrë të njëhershme. Më falni, do ta them edhe një
6 herë.

7 Mbrojtja argumentoi më tej, thanë se mënyra se si janë
8 paraqitur provat nga ana e ZPS-së përlligjin dorëzimin e
9 dosjeve gjyqësore njëra pas tjetrës.

10 Më 14 shkurt u kundërpërgjigj ZPS-ja dhe tha se në
11 përputhje me rregulloren dhe zhvillimin e procesit gjyqësor
12 dhe praktikat e mëparshme në këtë gjykata dhe gjykata të
13 tjera, palët dhe pjesëmarrësit duhet t'i dorëzojnë në të
14 njëjtën kohë dosjet gjyqësore.

15 Sipas ZPS-së, Mbrojtja e ka keqkuptuar qëllimin e dosjeve
16 gjyqësore përfundimtare që nuk është kundërpërgjigje e
17 Mbrojtjes - më falni - e një dosje tjetër, por është në
18 kundërpërgjigje të akuzave në aktakuzë dhe provave që kanë
19 dalë nga procesi gjyqësore.

20 Më 19 shkurt 2025, Trupi Gjykues bëri me dije dhe tha se
21 dosjet gjyqësore përfundimtare do të dorëzohen njëherazi.

22 Tani do ju japim dhe arsyet.

23 Ne jemi të mendimin që qëllimi kryesor i dosjeve
24 gjyqësore përfundimtare është që secila palë të paraqesë
25 provat e veta gjithmonë në përputhje me çfarë është zbardhur,

1 pra, çfarë ka ndodhur në një proces gjyqësor. Trupi Gjykses
2 nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes që dosjet gjyqësore të
3 dorëzohen në mënyrë konsektive.

4 Rregulla 34(b) dhe (c) e përcaktojnë qartë që duhen
5 dorëzuar njëherazi dosjet gjyqësore.

6 Edhe praktika e juridiksioneve të tjera nuk ka ndonjë
7 relevancë të madhe për ne, sepse kemi raste kur janë kërkuar
8 njëherazi; ka dhe raste kur janë kërkuar që të dorëzohen në
9 mënyrë konsektive dhe këto nuk janë të vlefshme për DHSK-në.
10 Për ne praktikë është praktika që ndjek Dhoma e Specializuar e
11 Kosovës dhe sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuar
12 të Kosovës dosjet gjyqësore duhet të dorëzohen njëherazi.

13 Në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes, aspektet
14 ballafaqese të procesit gjyqësor nuk përlligjin dorëzimin e
15 dosjeve gjyqësore në mënyrë konsektive. Prandaj, të gjithë
16 mund të paraqesin argumentet e tyre në dosjet e tyre
17 përfundimtare gjyqësore, nëse dëshirojnë ose mund të
18 përgjigjen me gojë në lidhje me këtë që po themi ne.

19 Sa i takun provave të ZPS-së edhe mënyra si janë
20 paraqitur provat e ZPS-së nuk është relevancë për Trupin
21 Gjykses. Mbrojtja e njeh shumë mirë çfarë provash ka ZPS-ja
22 dhe do të ketë mundësinë që t'i trajtojë të gjitha aspektet
23 përkatëse të këtyre provave në dosjen e tyre gjyqësore.

24 Për këtë arsye, Trupi Gjykses urdhëron që në përputhje me
25 rregullën 134 dhe praktikën e këtij juridiksioni dosjet

1 përfundimtare gjyqësore do të dorëzohen njëherazi.

2 Trupi Gjykses i kërkon Mbrojtjes të riklasifikojë ose të
3 dorëzojë një version të redaktuar publik të kërkesës së tyre
4 me numër F02799 [Sipas përkthimit], brenda të premtës.

5 Do japin edhe afatet kur -- do të dorëzohen dosjet
6 gjyqësore përfundimtare; do t'u japim udhëzime palëve dhe
7 pjesëmarrësve gjithashtu lidhur me disa aspektet çfarë
8 përmbajtjesh duhet të kenë këto dokumente dhe se çfarë presim
9 ne si Trup Gjykses në këtë dosje gjyqësore përfundimtare.

10 Dhe me kaq mbyll urdhrin me gojë.

11 Ju lutem, tani, sillni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjon
14 mirë?

15 DËSHMITARI: Po, z. Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

17 Prokurore, fjala është për ju.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit

19 PY. Z. Tara, dua të përiqem dhe një herë, të tregoj një
20 dokument për të kuptuar a bëhet fjalë për këtë dokument, pra,
21 këtë e ke fjalën ti.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
23 ekran materialin 083094 në ERN 083196. Shkojmë në faqen 15 të
24 anglishtes dhe 17 të shqipes në versionin në PDF.

25 DËSHMITARI: Jo, znj. Prokurore. Nuk është ky dokumenti.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 60

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

2 PY. Z. Tara, z. Tara, një çast s'e kemi vendosur. Do të them
3 unë. Kur ta vendosim në ekran them unë a është ky. Duro, ju
4 lutem.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim faqen 17 përbri këtij
6 dokumenti, ju lutem, shqipja.

7 PY. Z. Tara, këtë dokumentin ta treguam gjatë intervistës me
8 Prokurorinë në 2019 dhe ke bërë ca shënime te ky dokumenti. A
9 e ke fjalën për këtë dokument; ky është ai dokumenti?

10 PË. Znj. Prokurore, ju e dini saktë se cilin dokument -- për
11 cilin dokument e kam fjalën unë. Dhe të dy bashkëpunëtorët e
12 ty që kanë qenë në përgatitjen time e dinë saktësisht për
13 cilin dokument e kam fjalën.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 dëshmitar, vetën përgjigju pyetjes. Mos e komento -- mos
16 komento. Thjesht përgjigju dhe do vazhdojmë.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë që ta shohë
18 dokumentin të plotë dëshmitari. Që ta shohë të gjithë tekstin,
19 ju lutem, zvogëlojeni pak që të duket teksti i qarët.

20 DËSHMITARI: Jo, znj. Prokurore.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam dhe
22 dosjen në kopje fizike, janë letrat fizike që ia kam treguar
23 gjatë seancës përgatitore. Mund -- nëse dëshironi ia dorëzoj,
24 ju, Mbrojtjes në fillim ta shikoni dhe t'ia tregojmë një herë
25 dëshmitarit në letër këtë që kemi deklaratën. E kemi të

1 shtypur, të printuar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të tregoj dosjen, dosjen
4 me mekanizëm me kopjet e shtypura. Nëse mbase e ndihmon më
5 shumë dëshmitarin t'ia tregoj se çfarë ka parë. Vendosni ju
6 çfarë doni të bëni.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Përpara se të bëjmë këtë, a
8 mund t'i tregoni më mirë të gjitha faqet e dokumentit, mbase
9 t'i tregosh të gjitha faqet e dokumentit dëshmitarit, se
10 anglishtja ka vetëm faqen e parë.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër në shqip.
12 Zvogëloje që të duket pak më qartë. Që të duket e gjithë
13 faqja.

14 PY. A është ky dokumenti?

15 PË. Jo, znj. Prokurore.

16 PY. Do të tregoj edhe një faqe tjetër.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër. Më
18 poshtë, shkojmë në faqen tjetër.

19 DËSHMITARI: Jo, znj. Prokurore, nuk është.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. A është ky dokumenti?

22 PË. Jo, znj. Prokurore.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Në rregull. Të shohim Pjesën 4 të intervistës me ZPS-në
25 që është 083217-TR-ET. Shohim faqen 4 tek anglishtja, ju

1 lutem, shohim faqen, Pjesën 4. Shkojmë në faqen 10 tek
2 anglishtja. Faqja 11, më falni. Faqja tjetër tek anglishtja.
3 PY. Z. Tara, do të lexoj një pjesë të një deklaratë që ke
4 dhënë përpara ku të është treguar një dokument dhe këtu ke
5 thënë kështu, në rreshtin 15. Keni thënë kështu --

6 DËSHMITARI: Gjykatës, Gjykatës unë kërkoj dokumentin, jo
7 këta intervistat e mia, këta i kam lexuar të gjitha.
8 Dokumentin që më është paraqitur mua prej Prokurores --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prit të bëjë
10 pyetjen Prokurorja, një çast, një çast, Dëshmitar.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po të lexoj një pjesë të një
12 deklaratë që ke dhënë më përpara. Çfarë ke thënë ti për një
13 dokument - ti ke thënë kështu:

14 "Ka pasur takim në një vend ku kisha punuar pas luftës. U
15 takova me ata dy a tri herë. Nëse po flasim për të njëjtin
16 rast. Nëse është ky rasti atëherë më kujtohet çdo gjë tjetër.
17 Kjo ka qenë me italianin ... nuk e di kush ishte përfaqësues
18 atje. Nëse po flasim për të njëjtën gjë, e mbaj mend."

19 Më pas të thotë hetuesi:

20 "Jo, jo. Kjo intervista është kryer nga Anna Vannozzi."

21 Ti ke thënë:

22 "Një grua?"

23 "Një grua."

24 Përgjigja jote:

25 "Nuk e di."

1 "Nuk më kujtohet të jem takuar me ndonjë grua ..."

2 Pastaj të është bërë prapë pyetje:

3 "A të kujtohet të jesh takuar me ndonjë hetues të UNMIK-
4 ut në 2001?"

5 Dhe ti je përgjigjur:

6 "Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Po më kujtohet që
7 gjatë kohës që kam qenë komandant kam kuptuar që ishte dikush
8 hetues, po nuk e di. Ishte dikush që po kërkonte -- ndërpritet
9 këtu -- e di që ka qenë një rast, ka qenë një komandant i
10 OSBE-së që po kërkonte ish-punonjës që e kishte mamanë
11 shqiptare dhe babain serb dhe që është zhdukur në lagjen e
12 serbëve. Por nuk më kujtohet ndonjë takim me ndonjë grua që të
13 ketë qenë hetuese.

14 "Z. Dëshmitar, a ju kujtohet të jeni intervistuar për një
15 rast që ka lidhje me një viktimë Tasim Halimi?"

16 Jeni përgjigjur:

17 Nuk jam i sigurt a është e njëjta gjë ..."

18 "A ju kujtohet të jeni takuar me këtë e UNMIK-un, me
19 oficerin e UNMIK-ut, Anna Vannozzi në 2001, po ju pyes në
20 përgjithësi, a ju kujtohet të jeni takuar me këtë person."

21 Por ju thoni që ky takim është bërë, dhe ka një redaktim,
22 është fshirë.

23 "Njëqind për qind," jo ke thënë "por dhe mund ta kem
24 harruar. Jo nuk është, nuk ka qenë intervistë; nuk ka qenë në
25 formën e një interviste."

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 64

1 PË. Dokumentin tim që e kërkoj, ti e din shumë mirë, znj.
2 Prokurore. Dokumentin që unë e kërkoj ti e din shumë mirë [E
3 padëgjueshme].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta fika
5 mikrofonin, sepse nuk po i përgjigjesh pyetjes. Përgjigju
6 pyetjes së Prokurores që të vazhdojmë.

7 DËSHMITARI: Nuk përgjigjem pyetjes derisa nuk qitet asnjë
8 pyetje nuk i përgjigjem, derisa nuk paraqitet dokumenti që
9 kërkoj z. Gjykatës. Mund ta mbyllni seancën menjëherë, por pa
10 u paraqitur dokumenti nuk i përgjigjem asnjë pyetje tash e
11 tutje. Sepse dyshimi im është që kjo Gjykatë është gjykatë e
12 korruptuar dhe gjykatë që don [E padëgjueshme].

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta fika
14 mikrofonin sërish; ta hoqa mikrofonin.

15 DËSHMITARI: Fike ti sa herë të duash, por unë nuk do të
16 përgjigjem asnjë pyetje, pa u paraqit dokumenti, sepse unë jam
17 dyshues në tërë gjykatën [E padëgjueshme].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po ndiqni
19 rregullat. Ju lutem, heshtni, heshtni.

20 Vazhdoni.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Të nderuar Gjykatës, unë u përpoqa në çdo formë t'ia
23 tregoja dokumentet dëshmitarit. Unë tani do vazhdoj me pyetjet
24 e mia.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 65

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

2 PY. Z. Tara do t'ju bëj disa pyetje për rolin që ke pasur në
3 njësitin Arti. Çfarë keni bërë ju z. Tara në njësitin Arti?

4 PË. E dini të gjitha, por unë nuk flas asgjë më derisa nuk
5 paraqitet ai dokument.

6 PY. Kush ju caktu në atë pozitë që keni pas atje?

7 PË. Nuk përgjigjem për asgjë, derisa nuk ma paraqitni
8 dokumentin për shqetësimin tim, për sigurinë e jetës time, të
9 familjes time dhe për tradhtinë time sipas përshkrimit të ish-
10 gjykatës, hetues të mi me 2019. Derisa nuk zbardhet kjo nuk
11 kam asnjë përgjigje znj. Prokurore.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,
13 znj. Prokurore.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Trupit Gjykues ta
15 detyrojë dëshmitarin të japë përgjigje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Përkthim] Do t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar, apo jo?

18 DËSHMITARI: Nëse më jipet ajo [E padëgjueshme].

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, apo jo?

20 DËSHMITARI: Jo, para se më m'dhënë dokumentin --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, apo jo?

22 DËSHMITARI: Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoni që
24 po ju jap urdhër që t'i përgjigjeni pyetjes dhe në qoftë se
25 nuk përgjigjeni po shkelni rregullat e Gjykatës dhe mund të

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 66

1 gjobiteni nëse nuk përgjigjeni.

2 DËSHMITARI: Jo të gjobitem, por dhe të vritem nuk do të
3 flas pa e parë atë dokumentin se çka po bëni në këtë Gjykatë
4 ju. Edhe po të vritem nuk flas më, pa u shqyrtuar dokumenti në
5 fjalë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,
7 znj. Prokurore.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk ju dëgjova?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thashë
10 vazhdoni, vijoni.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

12 PY. Z. Tara, cilat kanë qenë detyrat tuaja kryesore në
13 njësitin Arti?

14 PË. S'kam përgjigje.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
16 pranimin e deklaratave të mëparshme të dëshmitarit në
17 përputhje me rregullën 143 të Rregullores, paragrafi 2(c) në
18 qoftë se dëshmitari nuk vazhdon -- nuk përgjigjet. Kjo mund të
19 bëhet me shkrim, në fakt, sepse duhet të përzgjedhim pjesët
20 përkatëse. Kështu që unë do ta bëj kërkesën me shkrim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
22 drejta juaj. Mbaruat me pyetjet atëherë?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, po. Nuk besoj se dëshmitari
24 do t'u përgjigjet pyetjeve të mia.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dixon.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Tani jemi në një pozicion ne,
2 fillimisht sipas nesh nuk janë shteruar të gjitha mjetet për
3 të marrë përgjigjet e dëshmitarit. Dëshmitarit nuk i është
4 shpjeguar çështja e mosbindjes së Gjykatës, as nuk është
5 konstatuar se nuk po i bindet Gjykatës. Pra, duhen ndërmarrë
6 disa hapa të tjera përpara se të bëjmë parashtrimet të
7 mëtutjeshme.

8 Gjithashtu nuk duhen pranuar këto deklaratat sipas nesh,
9 duke marrë parasysh që me sa duket ne si Mbrojtës do të kemi
10 mundësi të bëjmë kundërpjetje. Sidoqoftë është pak e
11 parakohshme kjo. Fillimisht sipas nesh duhen shteruar të
12 gjitha mjetet e mundshme ligjore që dëshmitari të japë dëshmi
13 përpara Trupit Gjykues dhe më pas ne si ekipet të Mbrojtjes
14 t'i bëjmë pyetjet tona dëshmitarit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka gjë
16 tjetër? Jo?

17 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari u
19 paralajmërua nga Trupi Gjykues dhe tha që nuk i bëhet vonë.
20 Dhe do vazhdojë të mos përgjigjet. Nuk e shohim nevojën për të
21 vazhduar më tej me procedurat e mosbindjes ndaj Gjykatës.

22 Ne do t'ju japim mundësinë t'i bëni pyetje nëse
23 dëshironi. Nëse nuk dëshironi ne do ta ndërpresim seancën dhe
24 do presim nga Prokuroria se çfarë hapash do të marrë në lidhje
25 me këtë.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Pikë së pari, çështja e mosbindjes
2 ndaj Gjykatës është një hap që mund të sjellë rezultate. Po
3 mendoj që është pak e parakohshme, po e theksoj këtë. Ky është
4 parashtrimi i parë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është --
6 ky është vendimi i Trupit Gjykses dhe vendosëm të mos e bëjmë
7 se nuk na shërben për asgjë. Zotnia refuzon të përgjigjet,
8 kështu që ne nuk do të konstatojmë se kemi rast të mosbindjes
9 ndaj Trupit Gjykses; kaq.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë, ne duhet ta dimë përpara se
11 të marrim ne vendimin se çfarë materialesh do përdoren. Ne
12 duhet të dimë çfarë materialesh do përdoren për provat
13 gjyqësore dhe bazuar në ato materiale do përgatitemi ne. Por
14 ne duhet ta dimë medoemos çfarë materialesh do kërkohen që të
15 pranohen si pjesë e provave gjyqësore, se po bëhet fjalë për
16 katër-pesë ditë dëshmi. Se nëse pranohet e gjitha duhet të
17 bëjmë ne pyetjet tona; duhet të shikojmë materialet e UNMIK-
18 ut. Ju lutem, duhet të merrni ju vendim fillimisht, pastaj të
19 vendosim ne çfarë pyetjesh do bëjmë e si do t'i bëjmë këto
20 pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po znj.
22 Tavakoli?

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mbështes z. Dixon. Unë mendoj
24 që fillimisht duhet të dilet me konstatim për mosbindje ndaj
25 Gjykatës. Nëse nuk e bëni atëherë ne duam ta dimë 100 për qind

1 çfarë dëshmie po jep ky dëshmitar. Është dëshmitar live, edhe
2 e vetmja dëshmi që kemi marrë sot është ajo që kemi dëgjuar
3 nga ora 09 e paradites sot. Kështu që ne do të detyroheshin të
4 bënim kundërpyetje bazuar në ato që dëgjuam këto tri orë.

5 Ne si avokatë mbrojtës nuk jemi në gjendje t'i bëjmë
6 pyetje pas pyetje dëshmitarit. Ju e keni parë, dhe nëse
7 pranoni ju të gjitha intervistat e tij, deklaratat e tij dhe
8 nëse ne nuk ia bëjmë dot pyetjet për këtë dhe nuk mund ta
9 bëjmë aktualisht, sepse nuk janë dëshmia e tij, dhe nuk janë
10 pranuar si prova gjyqësore. Prandaj duhet ta dimë
11 paraprakisht. Sa i takon mocioneve që do të dorëzojë
12 Prokuroria, standardi në rregullën 143(c) është, nëse
13 dëshmitari ka dhënë deklaratë mospërputhëse kolegia ime e
14 nderuar e lexon për procesverbal çfarë ka thënë dëshmitari për
15 deklaratën e UNMIK-ut. Është krejt në përputhje, gjithmonë ka
16 thënë nuk e kam dhënë këtë deklaratë. Sa i përkon -- takon
17 pjesës tjetër të dëshmisë që ka thënë sot, unë nuk konstatoj
18 asnjë mospërputhshmëri lidhur me ato që ka thënë edhe në
19 deklaratë për ZPS-në. Prandaj nuk mendoj se është e drejtë që
20 Prokurorisë t'i lejohet -- t'i kapërcejë hapat në mënyrë që të
21 pranohet dëshmia e tij dhe t'i mohohet kështu Mbrojtjes e
22 drejta për t'i bërë kundërpyetje dëshmitarit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
24 lejuar kapërcimin e asnjë hapi ne. Ne po presim të shohim
25 çfarë propozon Prokuroria.

1 [Mikrofoni çaktivizuar].

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Bashkohem me parashtrimin që u bë,
3 por dua të shtoj, po ashtu, dy pika.

4 Së pari, ne themi që nuk është ndërmarrë çdo hap, sepse
5 ekziston edhe mundësia që t'i tregohet dosja fizike, dosja me
6 mekanizëm dëshmitarit, siç edhe vetë e propozoj Prokurorja
7 para një çasti.

8 Dhe së dyti, unë do kërkoja kohë atëherë, përpara se të
9 merren hapat e tjerë. Sepse ne nuk e pritëm këtë situatë.
10 Erdhi krejt e papritur për të gjithë ne. Prandaj, përpara se
11 të fillojmë me kundërpyetjet është mirë që të na jepni kohë.

12 Z. MAIR: [Përkthim] Mbështes parashtrimet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurorja?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, po do kërkojmë -- do jua
15 tregojmë se çfarë materialesh do përdorim përpara se të
16 filloni me kundërpyetjet. Do ju themi se çfarë materialesh
17 duam të pranojmë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne s'mund ta
19 bëjmë këtë me dëshmitarin këtu. Mund ta bëjmë nesër, mund ta
20 bëjmë pasnesër, kur do ta bëjmë ne këtë punë?

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për hir të efikasitetit, është
22 mirë që të bëjmë një pushim të shkurtër që të marr të gjitha
23 referencat përkatëse dhe t'jua jap.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 [Përkthim] Doni të përzgjidhni disa nga materialet në

1 dosje, po thoni, jo të gjithë materialet.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Që të jemi të qartë, këtu
3 përfshihen edhe pjesë të intervistës me ZPS-në që lidhen me
4 aspektet që janë bërë me dije sipas rregullës 95 edhe shënimit
5 përgatitor dhe deklaratës së 2001-shit.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
8 gjysmë ore pushim. Po japim gjysmë ore pushim atëherë që të na
9 thoni se çfarë doni të bëni; çfarë hapash do ndiqni;
10 shpjegojani Trupit Gjykses bindshëm, qartë dhe Mbrojtjes, ju
11 lutem. Mblidhemi sërish në orën 12.30. Përgatituni.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Po ne duhet të kundërpërgjigjemi.
13 Kam frikë se nuk e bëjmë dot ne këtë sot. Jemi në një situatë
14 krejt të re tani. Nuk është mundësia në kohë kaq të shkurtër,
15 është goxha hap i madh për ne. Nuk mund të përgatitemi kaq
16 shpejt. Mund të kemi nevojë për më shumë kohë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 [Përkthim] Po s'kemi shumë kohë. Do duhet ta trajtojmë
19 sot.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Kemi gjithë javën; kemi gjithë javën
21 që të garantojmë që po respektohen të gjitha të drejtat.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

23 Dëshmitar. Z. Dëshmitar, ky është parashtrim juridik që nuk ju
24 takon ju. Çfarë doni të thoni ju?

25 DËSHMITARI: Vetëm një sqarim të shkurtër. Unë jo që nuk

1 do t'i përgjigjem kësaj Gjykate edhe Prokurorisë për çdo gjë
2 ajo më pyet. Do ta bëj shumë shpejt, shumë saktë dhe shumë
3 qartë dhe me shumë të drejtë me përgjigje të sakta. Por kërkoj
4 që dokumentin që unë e kërkoj të më paraqitet një herë e
5 pastaj shumë shpejt kanë me u krye të gjitha procedurat e mia.

6 Nuk e kundërshtoj unë që nuk do t'i jap intervistat --

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta fika
8 mikrofonin sërish. Ju po refuzoni të jepni dëshmi. U kemi
9 treguar plot dokumente dhe për çdo dokument keni thënë që nuk
10 e njoh. Dhe mbase, mbase të drejtë keni ju, mbase ky është
11 pozicioni juaj, por ama po refuzoni të jepni dëshmi.

12 Kështu që tani do bëjmë një ndërprerje të seancës, do
13 kthehemi për gjysmë ore dhe do të shohim se çfarë zgjidhje do
14 t'i japë Prokuroria.

15 Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit. Do shihemi
16 bashkë prapë për gjysmë ore.

17 DËSHMITARI: Ky është maltretimi edhe i Prokurorëve --

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mikrofonin ta
19 kam fikur sërish.

20 DËSHMITARI: Ju mund të bëni çka të doni, por [E
21 padëgjueshme] nuk është i drejtë.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, në
24 rregull. Bëjmë pushim deri në orën 12:30.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 12.01

1 --- Seanca rifillon në orën 12.31

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë pa praninë e dëshmitarit aktualisht.

4 Znj. Prokurore, a keni identifikuar pjesë të dokumenteve
5 që synoni që t'i paraqisni për pranim në prova gjyqësore?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Por
7 përpara sesa të kalojmë te kjo pjesa dua që të përpiqem dhe
8 një herë, për herë të fundit, që t'i tregoj dokumentin
9 dëshmitarit. Pra, t'i tregoj këtë dokumentin që ai thotë që ia
10 kemi treguar më përpara, duke krahasuar fjalë që ka thënë këtu
11 përpara Trupit Gjygues dhe atë çfarë ka thënë në shënim
12 përgatitor. Do i tregojmë, do mundohemi që t'i tregojmë
13 gjithashtu edhe dosjen fizike me fletë fizike të prekshme. Në
14 qoftë se do të më lejoni do mundohem që të përdor dhe këtë
15 mundësi të fundit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Do t'jua japim këtë mundësi. Në qoftë se kjo përpjekje e
18 fundit e juaja nuk do të japë rezultat, atëherë do ta nxjerrim
19 nga salla dëshmitarin dhe më pas do mundohemi që të gjejmë një
20 baraspeshë ndërmjet asaj çfarë thatë ju z. Dixon dhe do
21 vendosim se çfarë do të bëjmë me pjesën tjetër të ditës.

22 I lutem Sekretares të sjellë dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na dëgjoni në
25 rregull, Dëshmitar.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 74

1 DËSHMITARI: Po, z. Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Prokurore, e keni ju fjalën.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

6 PY. Z. Tare, sikurse e tha edhe Kryegjykatësi më herët është
7 shumë e rëndësishme për ne për të dëgjuar dëshminë tuaj
8 përpara Trupit Gjykses. Do të përpiqemi të bëjmë një përpjekje
9 tjetër për t'ju treguar dokumentin që keni kërkuar ju që t'ju
10 tregohet. Për ta bërë këtë gjë do përdor përshkrimin që keni
11 bërë ju vetë lidhur me këtë dokument. Pra, është përshkrimi që
12 keni bërë sot paradite, kështu që do ju kërkoja të dëgjonit me
13 kujdes atë çfarë keni thënë.

14 Sot në mëngjes kur ju kam pyetur për herë të parë për
15 këtë dokument, ju thatë:

16 "Në qoftë se ai moment për të cilin kam ngritur
17 shqetësimin tim dhe që ka vënë në rrezik familjen time dhe në
18 rrezik familjen time dhe mua personalisht që më ka etiketuar
19 mua si tradhtar i kombit, si tradhtar i UÇK-së, si tradhtar i
20 heronjve të kombit dhe të gjithë ata civilë janë masakruar dhe
21 që janë zhvendosur nga vendi përpara sesa të pastrohet emri im
22 dhe komandant Hoxhës, në atë dokument unë nuk do të jap asnjë
23 lloj deklaratë."

24 A ju kujtohet që më keni thënë edhe mua ekzaktësisht të
25 njëjtë fjalë kur unë ju kam treguar atë dokument? Pra, në

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 75

1 shënimin përgatitor kemi regjistruar ekzaktësisht të njëjtë
2 fjalë. A ju kujtohet të më keni thënë ekzaktësisht të njëjtën
3 gjë, kur e keni parë atë dokument, Dëshmitar?

4 PË. Po, znj. Prokurore.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
6 paraqesë në ekran tani dokumentin 125903. Të shohin faqen 21
7 të versionit në PDF.

8 PY. A ju kujtohet përgjigjet që keni dhënë ju gjatë seancës
9 përgatitore të cilat janë shkruar dhe më pas ju janë lexuar të
10 plota ju? Ju kujtohet të jetë bërë kjo gjë, Dëshmitar?

11 PË. A po ma tregoni dokumentin, apo një --

12 PY. Z. Tara, dëgjoni pyetjen. Jo. Po flasim për të njëjtën
13 gjë. Megjithatë, thjesht dëgjoni pyetjen, dëgjoni pyetjen
14 time. A ju kujtohet që kur folëm gjatë seancës përgatitore ne
15 kemi marrë shënim atë çfarë thatë juve dhe jua lexuam të plotë
16 atë që na thatë juve; a ju kujtohet jo si procedurë, si
17 proces?

18 PË. Po, të lutem --

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarit të kalojë
20 paragrafin 119.

21 DËSHMITARI: Të lutem, ma jep në shqip, ma jepni në shqip,
22 sepse unë nuk --

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

24 PY. Z. Tara, ju lutem, dëgjoni pyetjen për momentin. Gjatë
25 seancës përgatitore, sikurse regjistrohet në këtë paragraf, ti

1 më ke thënë, kur të kam treguar atë dokument, dhe i gjithë ky
2 dokument është i cituar këtu. Ju kur ju është treguar
3 dokumenti keni thënë si më poshtë:

4 "[Dëshmitari] ka lexuar dokumentin dhe ka thënë që
5 përmbajtjet e tij nuk janë të vërteta. Në qoftë se deklarata
6 do bëhet publike, do vihet në rrezik ai dhe madje edhe mund të
7 vritet nga dikush në komunitetin e vet. Dokumenti 'më
8 përshkruan mua si tradhtar të kombit tim, si tradhtar të
9 heronjve dhe të martirëve të UÇK-së si dhe tradhtar të
10 civilëve të vrarë dhe familjeve të tyre'. "[Dëshmitari] kërkon
11 që të mos nxirret ky dokument."

12 A ju kujtohet që ju keni përshkruar atë dokument, kur më
13 keni thënë këto fjalët që sapo ju citova?

14 PË. Po, sipas përshkrimit tënd dokumenti është për dokumentin
15 që flitet, por nuk kam kërkuar që të mos bëhet, mos bëhet --

16 PY. Në rregull.

17 PË. -- por kam kërkuar që në seancë menjëherë të diskutohet
18 më së pari për këtë dokument.

19 PY. Në rregull. Për këtë dokument jepet një kod. Domethënë,
20 ngjitur me këtë numrin 119 jepet kodi i këtij dokumenti. Ju
21 për këtë dokument e keni pasur fjalën.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretarit
23 që këtë dokument ta tregojë në një anë të ekranit; dhe
24 ndërkohë te faqja tjetër e ekranit të paraqesë dokumentin me
25 numër SPOE00144632.

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 77

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dëshironi që ta paraqes
2 në anglisht apo në shqip dokumentin?

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në shqip. Të kalojmë në fund të
4 dokumentit, faleminderit.

5 Ju kërkoj ndjesë. Ju lutem, paraqisni dokumentin në
6 anglisht -- jo, e thashë gabim. Më falni.

7 PY. A e shikoni numrin në fund të këtij dokumenti, Dëshmitar?

8 PË. Nuk është ky dokument që unë e kërkoj.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull. Mund ta heqim këtë
10 dokument nga ekrani.

11 Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoja që të mund t'i tregoja
12 dosjen fizike dëshmitarit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju japim
14 leje.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

16 PY. Z. Cara, -- z. Tara - më falni. Ky është një dokument i
17 cili është në kopje fizike që e keni lexuar gjatë seancës
18 përgatitore. Ju lutem, shihni dokumentin e parë në atë dosje
19 dhe na tregoni në qoftë se për atë dokument e keni fjalën apo
20 jo?

21 PË. Jo, znj. Prokurore.

22 PY. Në rregull.

23 Z. Tara. A vazhdoni t'i qëndroni asaj çfarë thatë më
24 përpara që nuk do t'i përgjigjeni pyetjeve të mia?

25 PË. Besa nuk ma paraqitni dokumentin për të cilin edhe ju e

Dëshmitari: Ismet Tara (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 78

1 dini cili dokument është, jo. Shkurt, [E pakuptueshme] jo.

2 Edhe sikurse të dënohem përjetësisht.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

4 Gjykatës, në këtë fazë unë dua që të kërkoj që të pranohen në
5 prova gjyqësore deklaratat e mëhershme të dëshmitarit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le ta
7 ndërpresim këtu për një moment.

8 Dëshmitari mund të dalë nga salla.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në frymën e
10 shterimit të të gjitha hapave do kërkoja që dëshmitari të
11 paralajmërohet për sanksionet që mund të merren kundër tij.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
13 uluni se s'kisha përfunduar së foluri.

14 Dëshmitari mund të dalë nga salla tani.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
17 kërkon regjistrimin edhe kërkimin e regjistrimit në prova
18 gjyqësore dokumentet duhet që të jetë shumë selektive, shumë
19 përzgjedhëse në natyrë. Duket sikur ka një dokument që ka një
20 rëndësi domethënëse. Kështu që do sugjeroni që të kërkonit
21 një numër të kufizuar dokumentesh për t'u pranuar si prova
22 gjyqësore dhe të ngrini vetëm çështje të cilat janë
23 thelbësore. Nuk dëshirojmë që ju të kërkonit 544 faqe që të
24 pranohet në prova gjyqësore, sepse duhet të jemi të sigurt dhe
25 duhet të jemi të barabartë për të gjitha palët.

1 Mbrojtja duhet të prezumojë që për qëllime të
2 kundërpyetjeve dokumentet mund të pranohen, por nuk do të
3 vendosim lidhur me ta derisa të përfundohet marrja në pyetje
4 nga ekipet e Mbrojtjes dhe pyetje plotësuese në qoftë se do të
5 kenë për këtë dëshmitar.

6 [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam dy aspekte
8 për të ngritur. Së pari, pasi u udhëzova nga klienti im, unë
9 do them edhe një herë që dua të përsëris kërkesën time për t'u
10 shteruar të gjitha hapat. Ne nuk e kemi pyetur këtë dëshmitar
11 lidhur me dokumentin që ai dëshiron që t'i paraqitet dhe ajo
12 çfarë është më e rëndësishme nuk janë marrë hapa sa i takon
13 rregullave për dëshmitarin për paralajmërimin e tij.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari
15 është paralajmëruar.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Pra, kjo është kërkesa ime që të
17 merren gjërat hap pas hapi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di që kjo
19 është kërkesa juaj, por nuk do të ndodhi kjo.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Në fakt këto janë hapa normalë për
21 proces për mosbindje.

22 Së dyti, ne duhet që të dimë se çfarë lloj përgjigje do
23 merrni juve për kërkesën ose mocionin që do të bëj Prokuroria.
24 Sikurse e thashë dhe më përpara, këto janë çështje të cilat
25 kanë dalë në momentin e fundit, kështu që ne na duhet që të

1 kemi më shumë qartësi lidhur me dokumente për të qenë në
2 gjendje që të japim përgjigje lidhur me pyetjet e këtij
3 dëshmitari.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetjet
5 plotësuese, pyetjet për dëshmitarin do bëhet pavarësisht se
6 çfarë ndodh. Ju keni qenë të informuar lidhur me deklaratat e
7 këtij dëshmitari dhe përmbajtjet e tij paraprakisht. Do t'ju
8 japim ca kohë, në qoftë se është e nevojshme, por do duhet që
9 të vazhdoni me pyetje.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dua që të bëj një kundërshtim
11 për procesverbal. Dëshiroj që t'i bashkohemi shqetësimeve të
12 z. Dixon dhe ftesë së z. Dixon që ju ta paralajmëroni
13 dëshmitarin për mosbindje ndaj Gjykatës. Juve e paralajmëruat
14 atë, i thatë gjithashtu që në qoftë se do jetë e nevojshme
15 mund të lëshoni një gjobë. Megjithatë, ne duam që t'ju
16 kërkojmë juve që të merrni masë mosbindje ndaj tij, sepse në
17 të kundërtën do jepet një mesazh për të tjerët të cilët
18 dëshirojnë të vijnë në Gjykatë dhe të mos japin dëshminë e
19 tyre që ata mund t'ia dalin dhe mund të mos japim dëshmi.

20 Sa i takon asaj çfarë i thatë Prokurorisë, e dëgjova, z.
21 Gjykatës që i thatë Prokurorisë që të ishin selektiv, të
22 përzgjidhnin ato dokumente të cilat janë më të rëndësishmet
23 nga ky dëshmitar. Megjithatë, në qoftë se do shikojmë
24 rregullin përkatës të ligjit, pra, që është rregulli 42(8), në
25 të thuhet që në qoftë se nuk detyrohet dëshmitari për të dhënë

1 dëshmi, dhe në qoftë se nuk përdoren instrumentet e
2 disponueshme, atëherë e drejta e të akuzuarit për të
3 konfrontuar ose për t'u përballur me dëshmitarë sipas nenit 21
4 të ligjit shkelet.

5 Pra, ajo çfarë dua të them dhe një herë, gjë të cilën e
6 përmenda më përpara, është që ne duhet të kemi më shumë
7 informacion, sepse në të kundërtën nuk kemi mundësi që të
8 vazhdojmë me pyetje për këtë dëshmitar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Qëllimi i preambulës është vetëm thjesht që të konstatojmë që
11 do kërkohen prova, do kërkohen dokumente për t'u pranuar.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne i bashkohemi kundërshtimeve
13 të thëna nga kolegët.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 z. Ellis.

16 Tani dua t'i kthehem Prokurores. A mund të na thoni se
17 cilat janë fushat për të cilat ju do kërkoni dokumente që të
18 pranohen në prova gjyqësore?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk mund të jap numrat ekzakte të
20 faqeve. Megjithatë, ne propozojmë që të redaktojmë pjesët për
21 intervistën e ZPS-së që lidhen me incidentin në vitin 2019 ku
22 dëshmitari është takuar me Driton Lajcin. Gjithashtu do të
23 dëshirojmë që të kërkohet të regjistrohen në prova gjyqësore
24 pjesët e mbetura të deklaratave të tij që kanë të bëjnë me
25 njohuritë që ka për njësitë e UÇK-së në vitin 1998.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duhet më
2 shumë informacion lidhur me këtë. A mund të na thoni në qoftë
3 se do kërkonti që të pranohen në prova gjyqësore pjesë të
4 caktuara, sepse duhet të dimë se çfarë pjesësh janë këto.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, fatkeqësisht
6 këto tema janë të ndërthurura në të 20 pjesët e deklaratës dhe
7 kjo është arsyeja që pse ne nuk mund të identifikojmë
8 ekzaktësisht tani se cilat janë ato pjesë ose cilat janë temat
9 përkatëse për të cilat ne do kërkojmë që të pranohen në prova.
10 Megjithatë, sa i takon takimit me z. Thaçi dhe më pas me
11 Driton Lajcin këto do kërkojmë që të redaktohen. Pjesën tjetër
12 propozojmë që të pranohen në prova gjyqësore.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pjesa e
14 faqeve 544 faqe --

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, së bashku me
16 shënimin përgatitor dhe deklaratën e UNMIK-ut si dhe provat
17 shoqëruese të diskutuara në shënimin përgatitor.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo nuk është
19 selektive. Nuk përzgjedhët ndonjë gjë të madhe.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E mbajtëm shënim këtë. Do ta ulim
21 më shumë numrin e provave.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutemi, na
23 thoni tani, Prokurore.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kufizohemi në dy
25 dokumente, çfarë do të thotë -- do të kufizohemi te skica e

1 dëshmitarit. Pra, skica që ka vizatuar vetë dëshmitari që i
2 është bashkëlidhur Shënimit Përgatitor numër 2 në përpjekje
3 për të kuptuar që çfarë po diskuton ai në dëshminë e tij.
4 Atëherë kjo është një temë e cila në dokumente trajtohet në
5 paragrafët 135 dhe 137. Numri ERN 024397 dhe ERN SITF00441811,

6 Të nderuar Gjykatës, për procesverbal dua që të vërej
7 gjithashtu që dëshmitari tha që i qëndron përgjegjeve që ka
8 dhënë në vitin 2019. Kjo është e pasqyruar në faqen 32, në
9 rreshtat 21 deri 23 dhe që këto deklaratat kanë të gjitha
10 elementët ose indiciet e autenticitetit dhe mbështetshmërisë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund t'ju bëj një pyetje
12 për sqarim?

13 Së pari, z. Dixon ju iu referuar Shënimit Përgatitor 2,
14 por me sa kuptoj unë ka vetëm një shënim përgatitor, apo jo?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është dëshmitar *viva voce*, kështu
16 që është vetëm një shënim përgatitor.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Së dyti, ju thatë: "Do ulni
18 numrin e dokumenteve që ju synoni që të pranoni në prova
19 gjyqësore ..."

20 E kuptoj qartë që ju do kërkonit skicën, por dokumenti
21 tjetër cili është?

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Janë ato të cilat unë kam
23 propozuar për praninë në prova gjyqësore.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, është -- janë deklaratat
25 të 2001-shit, të 2000-shit edhe këto keni si plan që t'i

1 kërkonte që të pranohen si prova?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Si prova
3 shoqëruese. Domethënë, është skica dhe këto dokumentet edhe
4 provat shoqëruese në shënimin përgatitor që ne do kërkojmë që
5 të pranohen ashtu si dhe intervista me ZPS-në.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë nuk është se keni
7 shkurtuar shumë numrin e faqeve që kërkonte që të pranohen në
8 prova, apo jo?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ka diskutime të shumta në takimin
10 e 2019 me intervistën me ZPS-në. Kështu që është e vështirë
11 për ne për të përzgjedhur pjesë të caktuara.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë mendoj që
13 gjëja më e rëndësishme është të dimë bazën ligjore ku
14 mbështetet Prokuroria kur thotë që do përdorë parashikimet e
15 rregullës 154. Dëshmitari synoj që të vinte të jepte
16 deklaratë këtu përpara Trupit Gjykses. Prokuroria pati
17 mundësinë të t'i drejtohej dëshmitarit dhe të merrte dëshmitë
18 e tij viva voce.

19 Ndërkohë që Prokuroria tani thotë që duhet të mbështetet
20 në rregullën 154, përfshirë këtu edhe Shënimin Përgatitor
21 numër 2. Ky është i gjithi informacioni i ri. Është një
22 informacion që vjen si rezultat i përmbledhjes së Prokurores
23 që është ulur përballë meje. Po pyetja që bëj unë është që si
24 është kjo deklaratë.

25 Është thjesht një përmbledhje e Prokurores, nuk është

1 diçka që e ka thënë vetë, në vetë të parë dëshmitari. Është
2 një çështje për të cilën do duhet të merret një vendim.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për sqarim për procesverbal, ne
4 po kërkojmë që të pranohet në prova gjyqësore intervista e
5 ZPS-së që ka numër ERN-je 083217-TR, dhe të 20-ta pjesët, duke
6 hequr ose duke redaktuar çështje që kanë të bëjnë me takimin e
7 2019. Shënimi përgatitor që ka numrin ERN 125903; tre prova
8 shoqëruese, dokumente shoqëruese për shënimin përgatitor.

9 Sikurse u tha dhe më herët sot ne kërkojmë që të pranohen
10 këto dokumente si prova gjyqësore në pajtim me rregullën 143,
11 paragrafi (2), germa (b) dhe (c) që parashikon konkretisht
12 këtë lloj kërkesë për pranim në prova gjyqësore të një
13 dëshmitari që ka bërë një përpjekje të vërtetë për të dhënë
14 dëshmi. Pranimi i deklaratës së dëshmitarit i cili refuzon që
15 të japë dëshmi mbi bazën e leximit të koordinuar ose të
16 gjithsej të rregullave 143 -- 143(2)(b)(c) dhe gjithashtu
17 është në pajtim me paragrafin 107 të Urdhrit për Zhvillimin e
18 Procesit Gjyqësor, vendimi F01821, ku Dhoma ka konstatuar se
19 deklarata e dëshmitarit i cili refuzon të japë dëshmi, në
20 qoftë se dëshmia e dëshmitarit i cili refuzon të japë dëshmi
21 është e papranueshme, kjo do të cenonte të drejtat e viktimave
22 për akses në drejtësi.

23 Faleminderit.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë
25 se do jemi në një situatë ku provat që kërkohen nga dëshmitari

1 do pranohen nga Trupi Gjykues dhe dëshmitari refuzon që të
2 dëshmojë edhe që t'i përgjigjet pyetjeve tona do gjendemi
3 përpara një situate ku nuk do të ushtrohet e drejta jonë për
4 të marrë në pyetje dëshmitarin. Kështu që kam përshtypjen që
5 shumë nga këto do të varen nga ajo çfarë qëndrimi do mbajë
6 dëshmitari. Domethënë, në qoftë se do i përgjigjet ose jo
7 pyetjeve tona.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Do
9 dalim nga salla për pak minuta.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më falni se
11 harrova diçka. Do të kërkoj gjithashtu që të pranohet në prova
12 gjyqësore deklarata e UNMIK-ut e 2001-shit.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe ne duam që të dimë se cila është
14 baza ligjore për pranimin në prova ligjore -- në prova
15 gjyqësore të këtij dokumenti. Sepse kjo është një deklaratë,
16 është një dokumenti i cili shkon përtej rrethanave në të cilat
17 mund të jetë i përfshirë ky dëshmitar sipas rregullës 143 dhe
18 të paktën nga dëshmia që ka dhënë dëshmitarit sot paradite,
19 nuk na rezultoi që dëshmitari di ndonjë gjë lidhur me këtë
20 dokument ose të paktën nuk është nënshkruar prej tij. Kështu
21 që do të donim të dinim bazën ligjore ku mbështetet Prokuroria
22 për kërkimin e pranimin të këtij dokumenti në prova gjyqësore?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Do bëjmë një pushim të shkurtër.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 12.55

1 --- Seanca rifillon në orën 13.08

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Pa praninë e dëshmitarit, udhëzojmë Prokurorinë që të kërkojnë
4 sot çfarë pjesësh duan që të pranohen. Kundërpyetjet do
5 rifillojnë -- do fillojnë në orën 2.30.

6 Nuk do japim asnjë vendim lidhur me materiale që kërkonte
7 ju të pranohen, sepse një pjesë e materiale që kërkonte ju mund
8 të mos pranohen sepse mund të jenë irelevantë dhe nuk lidhen
9 me çështjen tonë. Duhet të merrni parasysh që edhe mund t'i
10 pranojmë të gjitha materialet që kërkohen, bashkë me
11 deklaratat, por vendimin për pranimin e tyre, do ta marrim në
12 momentin e duhur në fund. Nëse dëshironi mund të bëni tani
13 kërkesën për pranimin e materialeve.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po më duhet kohë që të përgatis
15 faqet përkatëse.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mbase do përpiqem ta bëj brenda
18 orës 2.30.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Atëherë Mbrojtja le të fillojë kundërpyetjet nesër paradite.

21 Të jemi të sinqertë këtë material ju e keni pasur më përpara,
22 këto 544 [Sipas përkthimit] faqe, i keni lexuar. Mund t'i bëni
23 kundërpyetjet. Pranohen a s'pranohen, ju të përgatitur ishit.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Unë problemin me Prokurorinë e
25 kam dhe dua të ma konfirmojnë, a do përfshihen të gjitha

1 materialet që janë marrë në shtëpinë e z. Selimi; bisedat me
2 Driton Lajçin; kontakti që ka pas dëshmitari me ambasadorin --
3 ambasadorin e Kosovës kur ka ardhur në Hagë.

4 Ju lutem që -- unë do sugjeroja që këto të përjashtohen.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, po, këto do përjashton. Këto
6 s'do përfshihen.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit për kohën që na dhatë.
8 Por, pa e ditur ne çfarë do përdorë Prokuroria ne nuk mund të
9 bëjnë kundërpjetje. Duhet ta dimë çfarë kërkon Prokuroria të
10 pranohet dhe nuk duam të bëjmë pyetje për gjëra që s'do
11 pranohen si provë, si ta trajtojmë ne këtë gjë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
13 [Përkthim] Mund të pranohen, mund të mos pranohen. Janë
14 të dyja alternativat.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Po atëherë mbase do bëjmë ne pyetje
16 për materialet që s'do pranohen. Prandaj unë mendoj që duhet
17 të merrni një vendim për ato që do pranohen. Ne vlerësojmë
18 kohën -- e vlerësojmë kohën, t'i jepet kohë Prokurorisë të
19 shohim dhe ne çfarë do përdoret.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thashë, nuk
21 do marr vendim për t'ju bërë nder ju si ekipe të Mbrojtjes,
22 tani thoni që nuk doni që të marrim vendim, çfarë?

23 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, unë dua të di këtë: Prokuroria
24 fillimisht do bëjë kërkesën e vet për materialet që do të
25 pranohen. Pastaj ne duam t'i jep -- duam të kundërpërgjigjemi

1 dhe të jepni ju vendim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim
3 parasysh edhe këtë alternative.

4 Në rregull. Do bëjmë pushim deri në orën 2.30.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, më falni. Më falni, kam dhe
6 diçka tjetër që dua ta trajtoj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
8 [Përkthim] Do bëjmë pushim deri në orën 2.30. Në orën
9 2.30 ju do jepni referencat e materialeve që doni të pranohen.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem ta zgjidhim çështjen e
11 Dëshmitarit 02677 tani që të mos kemi kohë -- të mos çojmë
12 kohë dëm.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jemi pajtuar me Mbrojtjen që
15 dëshmitari -- pra, dëshmia e këtij dëshmitari të bëhet sipas
16 rregullës 153.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka pas
18 kundërshtime.

19 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, jo, ne kontaktua me Prokurorinë
20 të enjten, të premtën u pajtua pastaj të dyja palët që do të
21 përfshihen vetëm deklaratat e tij sepse provat materiale
22 shoqëruese janë tashmë pjesë e provave gjyqësore.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Përkthim] Nuk ka problem. Në rregull, nuk ka asnjë
25 problem për ne. E autorizojmë këtë gjë.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë atëherë,
3 do rikthehemi në orën 2.30. Deri atëherë do të bëjmë pushim.

4 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.13

5 --- Seanca rifillon në orën 14.29

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 sillni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tara, na
10 dëgjon?

11 DËSHMITARI: Po, zotëri Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Znj. Prokurore tani mund të kërkon pranimin e materialeve.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull. Ne duam të kërkojmë
15 pranimin e ERN-së 083217-TR-ET Pjesa 1 *Revised*, faqja 1,
16 rreshti 1, deri në faqen 15, rreshti 9; faqen 48, rreshtat 9
17 deri në 10.

18 Pjesa 2 *Revised*, faqja 1, rreshtat 1 deri në 17; faqja 2,
19 rreshtat 6 deri në faqen 8, rreshti 21; faqe 9, rreshti 4,
20 deri në faqen 20, rreshti 24.

21 Pjesa 3 *Revised*, të gjithë faqe. Janë shtatë faqe këto.

22 Pjesa 4 në tërësinë e vet. Në tërësi bëhet fjalë për 34
23 faqe.

24 Pjesën 5 *Revised*, nuk do ta kërkojmë

25 Pjesën 6 nuk do ta kërkojmë të pranohet.

1 Pjesën 7, po ashtu -- Pjesën 7, të tërë pjesën.

2 Pjesën 8, po ashtu të tërë pjesën.

3 Pjesën 9, duam të pranohet faqja 1, rreshti 1, deri në
4 faqen 6 rreshti 6.

5 Pjesa 10, kërkojmë pranimin e faqes 1, rreshti 1, deri në
6 faqen 2, rreshti 18; dhe faqja 9 deri -- nga rreshti 10 deri
7 në faqen 37, rreshti 9.

8 Pjesa 11 në tërësinë e vet.

9 Pjesa 12, po ashtu kërkojmë të pranohet e tëra.

10 Pjesa 13, kërkojmë pranimin nga faqja 1, rreshti 11; dhe
11 faqja 7, rreshti 21, deri në faqen 11, rreshti 21.

12 Nuk kërkojmë pranimin e Pjesës 14.

13 Në Pjesën 15, kërkojmë pranimin e faqes 1, rreshti 1,
14 deri në faqen 19, rreshti 20; dhe faqja 20, rreshti 2, deri në
15 faqen 23, rreshti 24.

16 Në faqen 16, të pranohet e gjithë faqja.

17 Ndërsa në faqen 17, të pranohet, ju lutem, faqja 1 -- dhe
18 një herë, më falni, faqja 1, rreshti 1, deri në 8; dhe faqja
19 8, rreshti 11 deri në faqen 19, rreshti 19.

20 Pjesa 18, kërkojmë pranimin e të tërë Pjesës 18.

21 Për pjesën 19, kërkojmë pranimin e faqes 1, rreshti 1,
22 deri në faqen 21, rreshti 20; faqja 22, rreshti 23, deri në
23 faqen 23, rreshti 2; në faqen 28, kërkojmë pranimin e
24 rreshtave 7 deri në 9; nga faqja 20, kërkojmë pranimin e faqes
25 1, rreshti 1, deri në 21; dhe faqe 6, rreshtat 17; në faqe 7,

1 rreshti 6; faqja 9, rreshti 7, deri në faqen 16, rreshti 15.

2 Po ashtu kërkojmë pranimin e Shënimit Përgatitor me numër
3 125903, 125933, dhe tre prova materiale shoqëruese. Prova e
4 parë e ka ERN-në 125932 deri në 125933. Prova e dytë, 024397
5 deri në 024399, dhe ERN-ja përndryshe është SITF00441811 deri
6 në 00441812.

7 Gjithashtu, do të kërkonim që të pranohej deklarata e
8 UNMIK-ut që mban numrin SPOE00144632 deri në 00144633 RED dhe
9 përkthimi në shqip.

10 Gjithashtu, dëshiroj të jap një parashtrim të shkurtër
11 lidhur me këto tri dokumente.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për intervistën e ZPS-së kemi
14 kufizuar materialet vetëm ato që lidhen me njësitet e UÇK-së
15 dhe anëtarët aktivë që operonin në zonën përreth Malishevës,
16 Drenocit dhe Rahovecit në verën e '98-s dhe verën e '99-s.
17 Porcionet që kërkojmë ne të pranohen lidhur me krimet e
18 pretenduara të kryera nga disa anëtarë të UÇK-së në këto
19 vendndodhje në verën e '98-s dhe në verën e '99-s dhe që
20 përmenden në aktakuzë. Pjesë të tjera, po ashtu, janë pjesë që
21 lidhen me të drejtat e të drejtat e dëshmitarit gjatë
22 intervistës së ZPS-së. Disa deklaratat të mëparshme dhe
23 shpjegimet që ka dhënë ai.

24 Deklarata e UNMIK-ut e 2001-shit është diskutuar gjatë e
25 gjerë në intervistën e ZPS-së dhe është komentuar nga

1 dëshmitari, i cili ka konfirmuar disa prej pjesëve dhe është
2 përdorur -- janë përdorur disa nga pjesët në intervistën e tij
3 për të dhënë informacione shtesë lidhur me rolin që ka pasur
4 ai në UÇK, aktivitetet që lidhen me këto vendndodhje, njësitë,
5 anëtarët dhe viktimat e përrshirë në aktakuzë. Ndonëse
6 dëshmitari e mohon tashmë këtë intervistë, ne gjykojmë që
7 është një material autentik, *prima facie*, edhe është
8 nënshkruar dhe firmosur -- nënshkruar dhe vulosur sipas
9 procedurave përkatëse gjatë intervistës.

10 Gjithashtu, sa i takon shënimit përgatitor, është po
11 ashtu relevant për të njëjtat arsye. Këto pjesë të shënimit
12 përgatitor lidhur me dokumente të cilat janë përdorur nga
13 dëshmitari për të komentuar dhe të cilat mund t'i japi peshën
14 e caktuar Trupi Gjykses kur të vijë momenti. Disa materiale,
15 në fakt, janë pranuar tashmë, disa kërkohen që të pranohen
16 tani. Komentet që ka dhënë dëshmitari në këto dokumente do ta
17 ndihmojnë Trupin Gjykses për të zbuluar drejtësinë. Sa i takon
18 besueshmërisë së këtij dëshmitari, edhe sjelljes së tij,
19 mendojmë që po ashtu pjesët e tjera që ne kërkojmë të pranohen
20 janë relevante për këtë dëshmitar, në mënyrë që të gjykoni
21 kredibilitetin e këtij dëshmitari, më falni.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tavakoli.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Desha të pyes një herë kolegen
24 për paragrafin 10 dhe 124 -- 142 të shënimit përgatitor. Mbase
25 duhen hequr këto nga shënimi përgatitor sepse lidhen me disa

1 nga materialet që nuk kërkohet që të pranohen si prova
2 gjyqësore. Për çështje përputhshmërie mendoj që këto dy
3 paragrafë nuk duhet të përfshihen në shënimin përgatitor,
4 duhet të hiqen prej tij.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] T'i heqim? Të
7 hiqen këto? Në rregull, atëherë. I heqim. Mirë atëherë.

8 Z. Dixon, doni të flisni tani apo nesër paradite?

9 Z. DIXON: [Përkthim] Nesër në mëngjes, se do na duhet t'i
10 shqyrtojmë të gjitha këto referenca tani dhe do ta bëjmë nesër
11 në mëngjes me gojë parashtrimin tonë edhe pastaj e marrim hap
12 pas hapi ditën. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
14 Tavakoli, po ju?

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Unë fola me kolegen time të
16 Prokurorisë, por do të donim që dhe ne t'i ngarkojmë
17 materialet tona nesër paradite, të shikojmë një herë
18 dokumentat që janë paraqitur. Prokuroria nuk kishte asnjë
19 kundërshtim për këtë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të katër
21 ekipet mund t'i nxjerrin materialet e tyre nesër në mëngjes,
22 nëse i keni gati në listën përkatëse të materialeve në *Legal*
23 *Workflow*.

24 Dëshmitar, për sot përfunduar. Tani mund të largoheni, po
25 do ktheheni nesër në orën 9.00. Nesër do të fillojmë pyetjet

1 nga avokatët Mbrojtës.

2 Në rregull? Keni diçka?

3 DËSHMITARI: Vetëm një kërkesë. Unë e kam zgjidhjen për
4 këtë proces që të kalojë në mënyrë të rregullt sikurse në
5 fillim që e kemi filluar, vetëm se nëse më lejohet vetëm
6 dhjetë minuta që unë t'ju spjegoj frikën time dhe pse jam unë
7 i frustruar prej popullatës time, ta njoftoj popullatën time
8 këtu në sallë të hapur pas dhjetë minutave të dëshmisë time.
9 Në lidhje me atë dokumentin që më është paraqitur prej
10 Prokurore, unë duhet të jem në gjendje të gjitha t'i
11 përgjigjem Prokurores në fjalë. Të gjitha! Të gjitha pyetjeve.
12 Vetëm dhjetë në seancë të hapur më duhet tash, në qoftë se
13 pranoni unë ta shprehi frikën dhe dyshimin tim rreth atij
14 dokumenti që më është paraqit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
16 ne ju dëgjuam ju sot paradite. E kuptojmë pozicionin tuaj. Ju
17 refuzuat t'u përgjigjeni pyetjeve. Ne kemi zgjedhur tani një
18 procedurë tjetër. Kërkesa juaj rrëzohet.

19 Do të shihemi nesër në orën 9.00 të mëngjesit. Nesër do
20 të fillojnë pyetjet avokatët Mbrojtës. Pra, mund të fillojmë
21 nesër rreth orës 9.00 me avokatët Mbrojtës.

22 Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.

23 DËSHMITARI: Nuk është problem. Po unë as nesër nuk do të
24 flas pa e ngritur shqetësimin tim në lidhje me dokumentin që
25 kam parë. Në këtë [E pakuptueshme] shqetësimin tim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
2 vendosi dëgjueset prapë. Vendosi, vendosi dëgjueset prapë.
3 Vendosi dëgjueset.

4 Ta thamë në fillim që do të japim mundësi në fund të
5 dëshmisë që ta bëje deklaratën që kishe për ta bërë. Ti nuk na
6 e dëgjove fjalën. Kjo ishte zgjedhja juaj. Ne kemi zgjedhur
7 një procedurë tjetër.

8 DËSHMITARI: Mua më duhet vetëm dhjetë minuta, *ten*
9 *minutes, Mr. Judge.* [E padëgjueshme].

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kemi dhënë
11 plot kohë sot paradite. Sot, për sot përfunduar. Ju lutem
12 largohuni nga salla e gjyqit.

13 DËSHMITARI: Okej. Nga unë nesër -- nga unë nesër dua një
14 avokat timin, ta gjeni sot, t'ja shprehi këtë shqetësimin tim
15 që e kam në qoftë se doni ju ta vazhdojmë. Po prapë duhet
16 dhjetë minuta para se të fillojmë me përgjigjet e mia, të
17 gjitha pyetjet çdokush që i bëni unë do t'i përgjigjem me
18 përgjegjësinë time të plotë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fatkeqësisht
20 ju thatë që në qoftë se do ua jepnim një dokument sot
21 paradite, do iu përgjigjeshit pyetjeve. Ju prapë nuk u
22 përgjigjët dhe kur ua dhamë mundësinë. Ju lutem largohuni nga
23 salla. Kemi përfunduar me ju për sot.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I lutem Zyrës

1 Administrative që marrë parasysh kërkesën e dëshmitarit për
2 një avokat, sepse do t'ja plotësojmë.

3 Rifillojmë nesër në orën 9.00 atëherë.

4 --- Seanca mbyllet në orën 14.43

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25